

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

Albanologu i arvanitëve

“Atje kam u shpirtin tim...”



Libër kushtim për 80-vjetorin e lindjes
së Anëtarit të Nderit të Akademisë së Shkencave
TITOS JOCHALAS

Tiranë 2022

Tryeza e lëndës

Tabula gratulatoria.....	7
Skënder Gjinushi	
Jochalasi ynë	11
Titos Jochalas, letër drejtuar Eqrem Çabejt	
(botohet për herë të parë)	14
Bio-bibliografi e akad. Titos Jochalas.....	15
Album fotografik	23
Francesco Altimari	
Një homazh i vogël akademik për një albanolog të madh të ditëve	
tona	47
Anila Omari	
Karakteri lokal-dialektor i sllavizmave të shqipes dhe rrugët e hyrjes	
së tyre në leksikun e shqipes së përbashkët	55
Albert Doja	
Presionet kishtare dhe politika e gjuhës: roli kufindarës e kufitregues i	
përdorimit të shqipes në shekujt XVII-XVIII.....	70
Andi Rembeci, Sokol Çunga	
Katalog i koleksionit historik të bibliotekës së AQSH.....	132
Bardhyl Demiraj	
Materiali shqip në veprën e mjeshtër Dhanilit <i>Eisagwgyikή Διδασκαλία</i>	
(1802)	161
Brian D. Joseph	
Some positive thoughts on Albanian negation.....	196
Giuseppina Turano	
Alcune curiosità linguistiche nell'Emira di Francesco Antonio Santori..	201

Dhori Q. Qirjazi

Títou, tríptuxon dórëma - Titos, dhurëtiljzë mbë trizë 248

Eda Derhemi

Zeriqi dhe etniciteti emérhumbur i arvanitëve: një esé narrative dhe një trajtëse teorike 280

Eno Koço

Titos Jochalas: mes letërkëmbimit tonë dhe *Skënderbeut* të tij (si dhe përsiatje në mbyllje) 295

Emil Lafe

Kur skajet pigen: *zhëmbëlë* (*Allfabetarja*, 1879) – *zhemel, zhamel-i* (*Bashkimi* 1908) ‘popël, gur i madh’ 313

Fiorella De Rosa

Serafina, Annamaria, Delia, Adine e Videlaide: ritratti di donne albanesi 317

Evalda Paci

Per un’analisi introduttiva ed analitica sulla letteratura ecclesiastica albanese (alcuni cenni storici) 328

Elena Botsi

The loneliness of the Arvanitologist 342

Fatos Dibra

Një diskutim mbi etimologjinë e dy fjalëve me burim oriental 345

Genc Lafe

I rapporti tra toponimi e voci ereditate dell’albanese sulla base dell’analisi della loro evoluzione fonetica 355

Gjovalin Shkurtaj

Titos Jochalas, *Elemente të gramatikës greqisht-shqip*, vepër e pabotuar e Jan Vellarait, 1985 371

José M. Floristán

Arvanitas naupliotas al servicio de los Austrias españoles 379

Konstantinos Giakoumis, Saimira Gjapi Përshkrime gjeografike të shek. XIX në zonat e Shqipërisë së sotme	394
Matteo Mandalà Çështja e gjuhës greke gjatë gjysmës së dytë të shekullit XVIII dhe kontributi i Tommaso Stanislao Velastit për lëvizjen e filohelenizmit napolitan	444
Mimoza Priku Rreth disa qasjeve albanologjike të Carlo Tagliavinit për arbëreshët e Italisë dhe të Greqisë	482
Blerina Suta La migrazione di termini e concetti in autori della tradizione letteraria bilingue italo-albanese: Pjetër Bogdani e Girolamo De Rada	492
Mimoza Ahmeti Kultura njihet nga një grua.....	511
Peter Constantine Language death and afterlife: the quest to document Arvanitika	515
Leonardo M. Savoia, Benedetta Baldi Neuter in Arbëresh dialects	524
Rexhep Ismajli “Tipari më i rëndësishëm arvanit...”	551
Shaban Sinani <i>Kangjelji VII:</i> nga De Rada te Kupitori; nga Mitko te Pekmezi e Jochalas	564
Pëllumb Xhufi Malet Brda, apo Malet Bardha?	593
Thomas Frashëri Frassina - Fraxhani - Frashëri: një rrugëtim historik dhe onomastik mes Shqipërisë dhe Helladhës në shekujt XV-XVI.....	614
Vasil S. Tole Një partiturë për akad. Jochalas	656

Titos Jochalas

Fjala në ceremoninë e shpalljes së tij Anëtar Nderi i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 24 mars 2012.....662

Prof. dr. Bardhyl Demiraj

**Materiali shqip në veprën e mjeshtër Dhanilit
Εισαγωγική Διδασκαλία (1802)**

Abstract

In this article, which I would warmly like to dedicate to our jubilee, I continue my historical and philological research within the Cultural Area of the Albanian Orthodox South, focusing once more on the early culture of written Albanian with Greek alphabet (Demiraj 2018; 2019a/b/c; 2020a/b). The object of the study is the textbook for beginners: Εισαγωγική Διδασκαλία (Engl. = Introductory lesson; Alb. = Mësimhyrës), a publication from 1802 by Daniil Mihali Adami Haçi, Moscopoleanul = (Greek) Δανιηλ Μιχάλι Αδάμι Χατζή ὁ Μοσχοπολίτης, (Alb.) Dhanil Mihal Adam Haxhi – Voskopojari, or, more commonly, Mjeshtër (Master) Dhanili.

We hope to have fulfilled at least the modest aim out marked in the beginning of this study, in relation to the philological and linguistic revaluation of the Albanian material in the Λεξικόν τετράγλωσσον (Engl. = Quadrilingual dictionary; Alb. = Fjalor katërgjuhësh) as the first part (p. 1-36) of this book. Getting the reader updated to the set of problems concerning the activity and the personality of its author (Dhanili) has been considered by the author of this work rather as a professional obligation to the discerning reader; nevertheless, we hope that this does not threaten in any way the main goal of the study, which consists in the critical edition of the Albanian text in that dictionary. It is this very text which – in its entirety – has still not become the property of the scientific and intellectual circles within the Albanian-speaking cultural area.

Within the paratextual and peritextual context of the oeuvre (§§1-3), the reader gets acquainted with the unnumbered introductory part of the book (p. I-VI), as the original Greek text with the corresponding Albanian translation, in a way that the reader can concept a clear idea and may even actively take part in the discourse connected to the problem field that goes along with these extensive goals which the author might have had in mind within his conception of the realization of the textbook; apparently, this seems have to do with the linguistic and cultural Hellenization of the Non-Greek ethnic communities that shared the Christian Orthodox belief inside the cultural area of the Albanian South. If we relativize the

authorship of (only) one of the pretexts which apparently constructs this ideologic and religious tendency of the linguistic acculturation, at the same time our aim was to calm down the souls of the intellectual and scientific Albanian circles that have abandoned the textbook as such in the index of forbidden literature and along with it also the Albanian material which it contains and that without any doubt represents a part of the valuable heritage of the written Albanian tradition with Greek alphabet at the end of the XVIII. century.

The task of the diplomatic reproduction and the extended transcription of the linguistic material (§§5-6.2) goes along in every phase with the graphemic and philological as well as the linguistic analysis of the text (§§ 4-4.2). In any case, in this highly difficult work period, help came from the continuous comparisons with the original Greek text as well and especially with the corresponding Aromanian text, which carries on paper the characteristics of the native vernacular of the author himself and the way the dialectical Albanian was perceived in his linguistic subconscious. The confrontation with these circumstances helped and ensured the last stage of our philological work upon the text (§6); its aim was the diplomatic reproduction of the Greek, the Aromanian and the Albanian versions, as well as the extended transliteration of the Albanian part (§6). These solid steps of philological work eventually enabled the realization of the normalized text (§6.3), which allows the fluent lecture for the interested reader, even without necessarily being a philologist. The genuine critical edition of the Albanian version goes along with two separate sections which close the study after the bibliographic section (§8): the Albanian lexicon with the corresponding word pool (§9) as well as the facsimile reproductions of this quadrilingual dictionary of the original edition from 1802 (§10). Seen from all these perspectives together, along with the corresponding conclusions (§7), we hope that the text and its author will soon become the property of Albanian Studies, giving it its own right place and undisputable role as an ocular witness of the linguistic and historical mosaic within a zone historically known for its multiethnic and multireligious coexistence: “It is a region which constructs the Gordian Knot within the cultural history of the Early Albanian Literacy, which can be untied and has to be solved along with the learning and studying of its component which is as young as it is ancient: the written Aromanian culture in the Cultural Area of the Orthodox South within the Albanian-Speaking Area.” (Demiraj 2019c 127)

Në këtë studim, që ia përkushtoj përzemërsisht Jubilarit si vëllamadh në shpirt e në zemër dhe gjithherë udhërrëfyes në punën time të natyrës historike-filologjike për Arealin e Jugut ortodoks shqiptar (Demiraj 2018; 2019a/b/c; 2020a/b), jam fokusuar rishtas në kulturën e hershme të shkrimit shqip me alfabet greqisht. Objekt studimi i radhës është materiali shqip që rroket në librin e mësimit për

fillestarë: Eισαγωγική Διδασκαλία (= shq. *Mësim hyrës*) si botim i vitiit 1802 e që ka për autor (arum.) Daniil Mihali Adami Haçi, Moscopoleanul = (gr.) Δανιὴλ Μιχάλι Αδάμι Χατζῆ ὁ Μοσχοπολίτης, (shq.) Dhanil Mihal Adam Haxhi – Voskopojarin.

Në letërsinë filologjike shqiptare emri i autorit njihet – sado skajshëm! – më fort si Mjeshtër Danieli (= dhaskal/mësues Danieli – Shuteriqi 1976 140), por së fundi Xhevati Lloshi (2006 87vv.; 2008 300vv.) mëton me të drejtë të korrigojë së bashku me përkatësinë etnike-gjuhësore të autorit si ‘shqiptar arumun’ edhe shqiptimin korrekt të emrit si Mjeshtër Dhanili (= [ðanīl-i]), një variant ky, të cilit do t'i mbetemi besnikë dhe me bindje edhe në këtë punim. Gjithsesi meritat e Lloshit nuk rrudhen assesi vetëm në korrigjime kësodore, sepse – thënë çiltas! – është studiuesi i parë në hapësirën kulturore shqipfolëse që i fshin këtij libri pluhurin e harresës dhe i jep jetë qoftë emrit të autorit ashtu edhe materialit shqip në të, duke përcjellë në diskursin shkencor-intelektual albanologjik një paletë të gjerë debati lidhur me historikun e studimit, me kornizën para- dhe peritekstuale të veprës sikurse edhe me njohjen e tekstit shqip në vetvete, përkatësisht të vendit të tij në trashëgiminë e kulturës së shkrimit shqip.

Përditësimi i lexuesit me këtë qerthull problematik që rrok veprën dhe personalitetin e autorit të saj është parë prej shkruesit të këtyre radhëve më fort si një farë detyrimi profesional ndaj lexuesit sqimatar, ndërkohë që qëllimi kryesor i studimit jet dhe mbetet botimi kritik i tekstit shqip në librin e vitiit 1802, i cili nuk është bërë ende si i tillë – më saktë në plotësinë e vet (!) – pronë e rretheve shkencore-intelektuale në hapësirën kulturore shqipfolëse. Prashtu më një ndërmarrje të kësaj natyre që përbën edhe objektin dhe qëllimin e një monografie të veçantë në një të ardhme të afërt, shpresojmë të plotësojmë një boshllék të përfshuar në hapësirën në fjalë për do arsyen që do t'i cekim në vazhdim.

Përmblodhëm kështu thukët përpos objektit dhe qëllimit të studimit edhe atë çka syzomjë t'i përcjellim lexuesit potencial në këtë punim si prurje tonën individuale, në mënyrë që ai të përditësohet dhe dikur – e pse jo! – të marrë pjesë aktive vetë në këtë diskurs.

1. Korniza peritekstuale

1.1. Mjeshtër Dhanili

Sa i përket autorit të librit në fjalë, të gjithë ata studiues që janë marrë deri sot me personalitetin e tij janë në unison:jeta dhe aktiviteti i Dhanil Mihal Adam Haxhi – Voskopojarit njihet pak, shumë pak. Atë çka dimë mund ta përmbledhim thukët: llagapi ‘Voskopojari’ (= arum.Moscopoleanul) markon pas gjithë gjasash vendlindjen e Mjeshtër Dhanilit, Voskopojën si qendra më e madhe urbane në Shqipërinë e Jugut në shek. XVIII. Në akademinë e këtij qyteti ai duhet edhe të ketë studiuar, madje pranë mjeshtrit po-voskopojar Thedhor Kavalioti dora vetë. Në qytetin ndërkojë të ngratë, të plaçkitur e të përcëlluar më shumë se një herë rezulton të ketë qenë aktiv edhe si mësues e drejtore shkolle gjatë viteve 1800-1811; sindëkur në po atë Voskopjë të rrëgjuar edhe për nga numri i banorëve duhet të ketë kaluar vitet e fundit të jetës si (prift) ikonom dhe predikues, bash ashtu siç dëshmojnë dy tapi të viteve 1819 dhe 1822. Me këto të dhëna të shprazëta përbledhin së fundi jetën e tij edhe Lloshi (2006 88) dhe Kyriazis (2019 47vv.), duke ju referuar sigurisht rezultateve sado të brishta të kërkimit prej hulmtuesi të apasionuar të arkivave dhe bibliotekave kishtare ortodokse Ilo Mitkë Qafëzezi (vitet 20-/30-të të shek. XX).

1.2. Libri shkollor *Εισαγωγική Διδασκαλία*

Ky libër shkolle me mësimë hyrëse për nxënës fillestarë rezulton të jetë së paku produkti i vetëm didaktik i Mjeshtër Dhanilit që e ka parë dikur dritën e botimit. E përmendëm me rezervë më lart në fjalët hyrëse si botim i vitit 1802, meqë në studimet e derisotme nuk është thënë ende fjala e fundit, nëse kemi të bëjmë këtu vërtet me botimin e parë në shtyp të tekstit origjinal, apo me një botim vjetor të radhës, më se i zakonshëm ky sot e gjithë ditën sidomos për tekste të denja shkollore. Asgjëmangut, kjo rrrethanë është gjithsesi rezultat i një ngërçi të përfshuar qysh në vitin 1814, kur Martin Leake ngérthen në veprën e vet *Researches in Greece* (London) rubrikën “Pentagloss Exercises” (f. 383vv.), ku lexohen pjesë të tëra të marra *enblock* ose me ndërrhyrje redaksionale prej fjalorit katërgjuhësh (Λεξικόν τετράγλωσσον f. 1-36 – sh. §5.1) që i prin tekstit mësimor greqisht (f. 37-92) të Mjeshtër Dhanilit. Veçse, ja!, ka gjasë vërtet që Leake-u të

dispononte atëbotë një ekzemplar të keqpërdorur të tipit të "Mesharit" të Buzukut (1555), që vjen me thënë që i mungonte ballina me faqet e para. Andaj edhe mjaftohet ndoshta të shkruajë se bëhet fjalë për "a small book called Lexicon Tetraglosson (gr. Λεξικόν τετράγλωσσον) printed in Greek charakter (I believe at Moskhópoli, about fifty years ago)." (f. 381) Përndryshe, studiues të tjerë e gjykojnë këtë vlerësim jo pa të drejtë si të dyshimtë deri të gabuar, duke iu referuar sipas rastit: a) vitit 1793 në korrespondencën e Mjeshtër Dhanilit lidhur me hartimin dhe shtimin e pjesës bullgarisht në fjalësin katërgjuhësh, një gjuhë kjo, të cilën ai pas gjase nuk e zotëronte (Capidan 1932 53vv.); dhe b) marsit të vitit 1794 që shfaqet dy herë në tekstin e Dhanilit në pjesën që përmban modele të hartimit të letrave, të cilat i drejtohen njérit apo tjetrit bartës të një funksioni kishtar ase laik. (Capidan 1932 57v.) Këta mbështesin në shumësinë e tyre, por jo të gjithë pa dilema të rastit, përfundimin e Capidan-it që botimi i parë i këtij libri pritet të jetë kryer në kapercyell të viteve 1793/4 (Kristophson 1974 8; Shuteriqi 1976 140 etj.). Një rrugë të mesme ndjek Hetzer (1982 142v.), i cili përsiat vitin 1802 si vit i botimit të parë të librit, ndërsa vitet 1793/4 si fazë e hartimit të tekstit të dorëshkrimit, i cili, kur qenka dërguar në shtypshkronjë, paska përjetuar përmirësimë te vogla redaksionale. Prashtu, sipas tij, teksti i hedhur në letër të bardhë i takuaka pas gjithë gjasash fundit të shek. XVIII e që mund të jetë shfrytëzuar potencialisht si i tillë edhe prej Leake-ut (Hetzer 1981a 28vv.; Kristophson 1974 13 etj.). Vërejmë së fundi që Lloshi (2006 96vv.) me stilin e vet gjithherë të vrullshëm, duke kundërshtuar çdo lloj botimi të mëparshëm, mëton që Leake-u në veprën tij duhet të ketë bërë së pari thjesht një përzgjedhje selektive të materialit gjuhësor prej botimit (të parë) të vitit 1802 e duke ndërhyrë më pas dukshëm në pikëpamje redaksionale në tekstin e Dhanilit në botimin e vet të vitit 1814.

Përpos çështjes së tekstit burimor (në dorëshkrim) sikurse asaj të vitit të botimit të parë, objekt diskutimi jet dhe mbetet edhe shtypshkronja, përkatesisht vendi i këtij botimi, meqë, ndërsa atij të supozuar në fund të shek. XVIII (? 1793/4) i mungonin pas gjase fletët e para, këtij të vitit 1802 i mungon qoftë vendi i botimit ashtu edhe emri i botuesit, përkatesisht i shtypshkronjës. Ndër gjykimet e dhëna deri sot më i besueshëm duket të jetë më i hershmi, shi ai i sllavistikës dhe balkanologut të shquar kroat Franz Miklosich (1882 230), i cili

vëren karaktere të ngjashme grafike me fjalorin e Kavaliotit (Venedik 1770) dhe përgjithësish me botimet greqisht në Venedikun e asaj kohe, duke parë bash këtu edhe vendin e botimit të librit mësimor të Mjeshtër Dhanilit në vitin 1802. Përsiatje të tjera mbi botime të mundshme në shtypshkronjën e Akademisë së Voskopojës apo ndoshta në Vjenë nuk gjeknë ndonjë mbështetje me argumente konkrete. (Capidan 1932 55)

1.3 Ribotime të fjalorit katërgjuhësh të Dhanilit

Ndërsa të dhënët për ndonjë ribotim të mundshëm të librit si të tillë e me të njëjtin funksion fillestar edhe pas viti 1802 mungojnë, interesimi ndaj tij në mjediset e ndryshme shkencore në Europë bëhet më se i dukshëm qoftë nëpërmjet ribotimeve të pjesshme, më saktë të pjesës hyrëse (f. 1-39), të realizuar si fjalor tekstor me lexim vertikal paralel në katër gjuhë (greqisht, arumanisht, bullgarisht dhe shqip), ashtu edhe të shfrytëzimit të materialit gjuhësor në studimet e mirëfillta të gjuhëve pak ose aspak të njohura të Ballkanit, siç ishin aso kohe shqipja, dialekti arumun apo bullgarishtja/maqedonishtja e ligjërimit të thjeshtë (Kristophson 1974 8ff. etj.).

Rol kryesor në këtë drejtim ka luajtur padyshim ngérthimi sado i pjesshëm e me ndërhyrje të dukshme redaksionale i materialit burimor në veprën e Martin Leake-ut (= L 1814) e po në shek. XIX edhe ai i materialit gjuhësor arumanisht në studimet e Franz Miklosich-it (= M 1882). Në vitin 1841 ndeshim gjithashtu botimin e Teodos Sinaitskit (= S 1841 – Kristophson 1974 13 dhe Lloshi 2006 91ff) që përpunon në mënyrë redaksionale materialin greqisht dhe bullgarisht të fjalorit, duke i shtuar atij edhe karamanlishten, d.m.th. të folmen e turqve të krishterë karamanlinj dhe gagauzë në trevat bullgare të asaj kohe. Ndryshe nga botimet e Leake-ut dhe të Miklosich-it që përcjellin interes të mirëfilltë njohës e shkencor të materialit gjuhësor, botimi i fundit ecën në të njëjtën hulli me qëllimin burimor të librit të Mjeshtër Dhanilit, pra me u përdorur si libër mësimi i greqishtes, parë kjo si gjuhë prestigji kulturor dhe liturgjik, më saktë si mjet komunikimi në orientimin drejt helenizmit, përkatësisht kulturës ortodokse bizantine.


Në shek. XX dallohen botimet kritike të fjalorit të plotë prej Pericle Papahagi-t (= Ph 1909) dhe së fundi prej Jürgen Kristophson-it (= Kr 1974), ndërkohë që nuk mungojnë botime të pjesshme për materialin

bullgarisht (Pogorělov = P 1924 – sh. Kristophson 1974 9), pér materialin greqisht dhe bullgarisht prej Ničev (= N 1977– sh. Llosi 2006 96) si edhe pér fjalësin greqisht prej Angeliki Konstantakopulu (= KO 1988– Llosi 2006 88ff.) të fjalorit katërgjuhësh (f. 1-36).

Mijëvjeçari i ri shënon edhe fillimin e studimeve të mirëfillta të natyrës filologjike mbi veprën e Mjeshtër Dhanilit në hapësirën shqipfolëse. Kufizohemi këtu sigurisht me prurjet e padiskutueshme të mjeshtrit filolog dhe albanolog Xhevati Lloshi (2006 87-99; 2008 300-305), si pjesë e ndërmarrjeve të tija ballore në kulturën e shkrimit shqip me alfabet greqisht (sidomos) në shek. XIX, ku feksin transkriptimet e korifejeve të kësaj kulture, bash ata të rangut të Vangjel Meksit, të Grigor Gjirokastritit e sidomos të Babait të Shqipes, Konstandin Kristoforidhit. Në vazhdën e përkthimit shqip të veprës së Leake-ut (1814) Llosi nuk mungon assesi të transkriptojë me seriozitetin e punës ekdotike me tekstet e vjetra shqip edhe rubrikën “*Pentagloss Exercises*” (= shq. *Ushtrime në pesë gjuhë*, Llosi 2006 257-287), ku siç përmendëm më lart (§1.2), Leake-u përcollit në botën shkencore europiane pjesë të tëra prej fjalorit katërgjuhësh që i prin librit mësimor të Mjeshtër Dhanilit. Gjithsesi nuk kemi të bëjmë këtu thjesht dhe vetëm me një transkriptim të thjeshtë të një ribotimi të dikurshëm të këtij teksti në pesë gjuhë (+ anglisht), sesa edhe me qëmtimin e ndërhyrjeve të dukshme redaksionale që i janë bërë në atë ribotim vetë tekstit burimor. Llosi po aty (2006 370-376) i përcjell lexuesit në shqipen e sotme (Ll 2006) një përshtatje të lirë të tekstit shqip të botimit të Leake-ut (L 1814) me plotësimet përkatëse prej botimit të Kristophson-it (Kr 1974).

Në bashkëvajtje me qëllimin kryesor të punimit tonë, në të cilin syzomjë riprodhimin diplomatik të fjalorit të Mjeshtër Dhanilit (1802), përkatësish botimin kritik si tekst i përkujdesur i pjesës shqip në të, jemi të detyruar t'i rrëfejmë lexuesit, se jemi përqendruar në punën tonë ekdotike me tekstin (D 2020) thjesht dhe vetëm në botimin më të hershëm që disponojmë deri sot (II 1802) e duke konsultuar sipas rastit ribotimet gjegjëse P 1909 dhe Kr 1974.

Stema e (ri)botimeve të derisotme të fjalorit sipas modelit të Kristophson 1974:



Legjenda:

- Vijë drejtvizore: ribotime të mbështetura në burimin e parë të njohur.
- Vijë e ndërprerë me shigjetë: ribotime të mbajtura parasysh në punën ekdotike me tekstin.
- Vijë e ndërprerë pa shigjetë: marrëdhënie të hamendësuara pa forcë argumenti

1.4 Funksioni dhe qëllimi i tekstit burimor

Pjesë e kornizës peritekstuale janë padyshim edhe funksioni dhe qëllimi i tekstit burimor, që janë mësimi i greqishtes si gjuhë komunikimi dhe hapat e parë në formimin humanist në kulturën helene-bizantine për nxënës të krishterë jonativë në një shkollë të konceptuar si e tillë me njohur dhe përvetësuar pikërisht këtë kulturë. Kufizohemi në këtë gjykim thjesht dhe vetëm të joshur në fatin që ka përjetuar teksti i Mjeshtër Dhanilit në trashëgiminë e kulturës së shkrimit shqip dhë në historikun e studimit të kësaj kulture në filologjinë shqiptare. Dhe nuk ekzagjerojmë aspak në këtë rast, në qoftë se e vendosim këtë botim në *index librorum prohibitorum* në Shqipërinë e gjysmës së dytë të shekullit të kaluar e që ka të bëjë padyshim me interpretimin e vargëzimit në f. V (të panumëruar) të botimit të vitit 1802, me autor *ndoshta* Mjeshtër Dhanilin dora vetë e ku lexuesit, me saktë nxënësve fillestarë ortodoksë të bashkësive etnike jogreke, u trumbetohen me hosana në vargjet e para gjithë ato të mira që u sjell përvetësimi i greqishtes si gjuhë hyjnore e liturgjisë

bizantine dhe e qytetërimit helen, përkatësisht heqja dorë vullnetarisht prej gjuhëve amtare, të ashtuquajtura barbare si arumanishtja, bullgarishtja dhe shqipja. (sh. më poshtë §2.2.2/c)

Pa dashur assesi t'i anashkalojmë kumtit të atyre vargjeve, duke vënë në dyshim së paku autorësinë e tyre në emrin e hartuesit të librit mësimor¹ e më tej platformën e ashtuquajtur hegemoniste e asimiluese të Kishës Ortodokse Greke², lejohemi të mëtojmë se ky qëllim final nuk sendërtohet assesi në çdo faqe të botimit në fjalë. Mjafton të përmendim këtu përkushtimin e Mihal Schina-s në f.II (të panumëruar) menjëherë pas ballinës së librit, ku – thënë çiltas! – himnizohet bash e kundërtta, çka vjen me thënë njohja dhe përvetësimi i këtyre gjuhëve në lutjet dhe përgjërimin ndaj Zotit. (§2.2.2/a)

Në rast se çështje të kësaj natyre ua përcjellim tash natyrshëm – ashtu siç edhe pritet!! – studimeve të mirëfillta kulturore-historike në zhvillimet që përjetoi Kisha Greke-Bizantine prej gjysmës së dytë shek. XVIII e deri në vitet 30-të të shek. XX në Arealin ortodoks shqiptar, atëherë përforcojmë po aq natyrshëm bindjen se teksti shqip i ngërthyer në këtë libër mësimi greqisht pér fillestare është një pasuri e patundshme e kulturës së hershme të shkrimit shqip me alfabet greqisht në hapësirën shqipfolëse e si e tillë mund edhe do mbajtur parasysh e hulumtuar në studimet e trashëgimisë së kësaj kulture. Ajme, përfundojmë pikërisht këtu këtë rubrikë duke cituar Lloshin (2006 90), sipas të cilit: "...Çështja kufizohet brenda rrëthit fetar dhe

¹ Fakt është që këto vargje që e kanë zhveshur deri sot prej çdo lloj stime e respekti Mjeshtër Dhanilin dhe librin e tij, nuk shfaqen assesi në tekstin mësimor të hartuar prej tij, i cili si i tillë i nënshtronhet numërimi me shifra arabe. Ato i takojnë thjesht prej rubrikave të panumëruara dhe pa emër autorit në pjesën hyrëse të këtij libri, madje në vargëzimin në fjalë lëvdohet jo pa arsyet vetë emri i Mjeshtër Dhanilit në vetën e tretë (f. V-VI, shën. 7). Është pikërisht kjo rrëthanë që i lëkund disi paragjykimet e derisotme, përkatësisht atë linçim pas gjase të pamotivuar ndaj autorit lidhur me syzime afatgjata të natyrës ideologjike-fetare që rrrok (vetëm) ky vargëzim si i tillë.

² Sipas Kristophson-it (1974 7): "...Për llojin e vet është një libër mësimi kryekrejet praktik, sepse ashtu mund të mësonin greqishten fëmijë prej tri nacion[alitet]eve. Libërthi është produkt i iluminizmit. Popuj të vegjël "alloglossoi" duhej të rrokeshin në një bashkësi të madhe kulturore-gjuhësore. Kështu ishte [dikur – B.D.] edhe një program jozefin pér të gjermanizuar të gjithë popujt e Austro-Hungarisë. Në këtë program iluminizmi nuk duhet të përqaset me përpjekjet e denacionalizimit në kohën e Nacionalizmit, siç paragjykon I. Ivanov-i [Sofje 1912] Dhanilin."

brenda mitit mitologjik se ortodoksët identifikohen si grekë e prandaj gjuha e tyre duhet të jetë vetëm greqishtja. Rrjedhimisht nuk është me vend të pohohet, se thirrja u drejtohej kombësive të ndryshme të Ballkanit: thirrja e Dhanilit ishte vetëm për bashkësitë ortodokse. Pikërisht nga një përgjithësim i tillë përtrej së vërtetës historike, për shumë kohë puna e Dhanil Voskopojarit nuk është vlerësuar në punimet tona.”

2. Teksti mësimor: organizimi dhe korniza paratekstuale

Lë të ndalemi tash konkretisht në një rubrikë të veçantë që ka të bëjë me organizimin e gjithë tekstit si sendërtim i librit mësimor të Mjeshtër Dhanilit, botim i vitit 1802.¹

2.1 Teksti mësimor në vetvete

Prashtu teksti si i tillë është i organizuar në 91 faqe të numëruara me shifra arabe, të cilave u paraprijnë të panumëruara 8 faqe hyrëse si paratekst (f. I-VIII), duke u përmbyllur edhe me një faqe po të panumëruar me ndreqje gabimesh (f. 91 + IX). Në 91 faqet e numëruara si tekst mësimor feks paraprakisht fjalësi katërgjuhësh (f. 1-36), funksioni i të cilës është t'u mësojë rishtarëve me origjinë arumune, bullgare dhe shqiptare greqishten si mjet komunikimi dhe gjuhë mësimi në shkollë dhe si t'u drejtohen me shkrim eprorëve në hierarkinë e administratës së Kishës Ortodokse Greke. (f. 37-39)

Faqet në vijim rrokin: (a) një hyrje në doktrinën e krishterë në formë dialogu mësues-nxënës (f. 39-53), ku rishtarët mësojnë të qënët i krishterë me karakteristikat përkatëse dhe njohuritë e para të sjelljes si të krishterë të devotshëm ndaj Zotit; (b) njohuritë fillestare mbi elementet e para të fizikës dhe fenomenet natyrore, ku kumtohet: për tokën, ujin, ajrin, zjarrin, botën, qiellin, ylberin, tërmetin, për pesë shqisat, shpirtine paarsye, që vjen me thënë ndjesitë e kafshëve si edhe për shpirtin me arësyte të njeriut. (f. 54-59). Faqet 60-71 janë konceptuar si (c) hyrje në mjeshtërinë e të shkruarit bukur, përkatësisht në hartimin e letrave ndaj patrikut igumenik, metropolitit, murgut, priftërinjve murgj dhe igumenikë etj.; në konceptimin dhe hartimin e testamenteve, dhuratave etj. Në vijim

¹Një përshkrim të parë e të detajuar në këtë drejtim mëton botimi i hershëm kritik i P. Papahagi-t (1909 105vv.: Invățătură introducătoare de Daniil Moscopoleanul).

autori përqendrohet në (d) njojuritë e para të matematikës, ku u kushtohet vëmendje përvetësimit të katër veprimeve themelore në arithmetikë (f. 72-82). Në f. 83 është rrokur (e) rregullorja që duhet të ndjekin nxënësit në shkollë e në vijim (f) kemi njouri të ndryshme mbi festat e mëdha fetare ase syresh të shenjtorëve (f. 84-86), duke vijuar së fundi me (g) me llogaritjet për të gjetur me saktësi kapërcyellin e viteve nga viti i vjetër në vitin e ri sipas sistemit diellor dhe atij hënор etj. (f. 87-91)

2.2 Korniza paratekstuale

Sic përmendëm më sipër (§2.1) teksti mësimor rrrethohet me do faqe hyrëse të panumëruara (I-VIII) si edhe në fund me një tjetër po të panumëruar (91+IX) për ndreqje gabimesh, të cilat lejohemi t'i vështrojmë në kuadrin e kornizës paratekstuale që rrok botimin si libër në vetvete. Përshkrimi i tyre deri edhe përkthimi i ndonjë pjese që ngërthehet në to¹ shpresojmë të ndihmojë lexuesin në përfimin e një gjykimi individual lidhur me funksionin themelor të tekstit mësimor në vetvete, sindëkur edhe atë syzim ‘antikombëtar’ që i vishet autorit kohë pas kohe dhe rast pas rasti lidhur me të ashtuquajturin program helenizimi të bashkësive ortodokse shumëgjuhëshe në trojet që rroknin atëbotë Arealin e Jugut ortodoks shqiptar. (§1.4)

2.2.1 Ballina e librit

Parë nga kjo perspektivë lejohemi të përqendrohemi fillimisht në ballinë e librit (f. I) ku përpos titullit të thukët, në vijimin e tij të parashikuar si nëntitull lexuesi mëson gjithçka për përbajtjen librit në vetvete:

f. I	MËSIM HYRËS
ΕΙΣΑΓΩΓΙΚΗ ΔΙΔΑΣΚΑΛΙΑ Περίεχουσα Λεξικόν Τετράγλωσσον τῶν τεσσάρων κοινῶν Διαλέκτων ἡτοι τῆς ἀπλῆς Ῥωμαϊκῆς, τῆς ἐν Μοισίᾳ	Rrok një fjalor në katër gjuhë të atyre katër dialekteve të përbashkëta, d.m.th. të gjuhës

¹ Falënderoj me këtë rast përzemërsisht Sokol Çungën për ndihmën e pakursyer në përkthimin aspak të lehtë të teksteve hyrëse greqisht në faqet (e panumërura) hyrëse I-VI. Për çdo parregullsi të mundshme në përkthim është sigurisht shkruesi i këtyre radhëve që bart përgjegjësinë shkencore.

<p>Βλαχικής, τῆς Βουλγαρικής, καὶ τῆς Άλβανιτκής.</p> <p>Συντεθεῖσα μὲν ἐν ἀρχῇ χάριν εὐμαθείας τῶν Φιλολόγων ἀλλογλώσσων νεων παρὰ τοῦ Αίδεσιμωτάτου καὶ Λογιωτάτου Διασκάλου, Οἰκονόμου καὶ Τεροκήρυκος Κυρίου Δανιὴλ τοῦ ἐκ Μοσχοπόλεως. Καλλυνθεῖσα δὲ καὶ ἐπαυξηθεῖσα τῇ προσθήκῃ τινῶν χρειαδῶν καὶ περιεργείας ἀξίων, καὶ εὐλαβῆς ἀφιερωθεῖσα τῷ Πανιερωτάτῳ, καὶ Λογιωτάτῳ Μητροπολίτῃ Πελαγωνείας, Ὑπερτίμῳ, καὶ Ἐξάρχῳ πάσης Βελγαρικῆς Μακεδονίας Κυρίῳ</p> <p>KYΡΙΩ ΝΕΚΤΑΡΙΩ</p> <p>ΤΩ ΕΚ ΜΟΥΝΤΑΝΙΩΝ</p> <p>Οὗ καὶ τοῖς ἀναλόμασι τύποις ἐκδέδοται δι ὠφέλειαν τῶν Επαρχιωτῶν αὐτοῦ εὐλαβῶν Χριστιανῶν.</p> <p>Ἐν ἔτει σωτηρίῳ αωβ'. 1802.</p>	<p>romajke [= greqishte], të vllahishtes së Misisë, të bullgarishtes dhe shqipes.</p> <p>Hartuar në fillim prej mësuesit, ikonomit dhe predikuesit tejet të respektuar dhe të aftë, qir Dhanil Moscopolit-it për t'i shërbeyer mësimit të lehtë rishtarëve të gjuhëve të tjera. Përmirësuar dhe shtuar me përvetësimin e disa gjërave të dobishme dhe të denja për kuriozitetin dhe me respekt përkushtuar më të shenjtit dhe më të diturit Metropolit të Pelagonisë, më të nderuarit dhe Eksarkut të gjithë Maqedonisë bulgare, zotit zotit Nektari</p> <p>të Mudanva-s [ndanë Marmarasë/Turqi]</p> <p>me shpenzimet e të cilët u shtyp, përdobi të të krishterëve shpresëtarë, të Eparkisë së tij.</p> <p>Në vitin shpëtimtar 1802</p>
---	--

2.2.2 Vargëzime hyrëse

Në f. II-III¹ janë rrokur tri vargëzime me përkushtime të rastit ndaj Metropolitit të Pelagonisë që mundësoi pas gjase botimin e librit. Ndër to vargëzimi i parë me autor Mihail Schima² paraqet më shumë interes, meqë kumton ndër të tjera edhe dëshirën e tij me njojur të katër gjuhët që rroken në atë libër, ndërsa vargëzimi i dytë kumton emrin e Mjeshtër Dhanilit si hartues i tekstit mësimor dhe atë të mecenit të shtypit të librit, si vijon:

¹Shmangje në radhitje të faqeve midis dokumentit tonë facsimile që kemi shkarkuar prej burimesh të sigurta elektronike: <https://upload.wikimedia.org/wikipedia/commons/8/87/Eisagogiki-Didaskalia.pdf> (dt. 30.04.2021) dhe përshkrimit të bërë nga P. Papahagi 1909 105vv.

²Emri dhe personaliteti i këtij personi mbeten sot për sot të panjohura.

a)

f. II	
<p>ΣΤΙΧΟΙ ΜΙΧΑΗΛ ΣΧΟΙΝΑ ΩΣ ΕΚ ΤΗΣ ΒΙΒΛΟ</p> <p>“Ηθελον νὰ ἔχω γλῶσσαν τὸ τετράγλωσσον ἐγώ.</p> <p>Γιὰ νὰ ἡμπορῷ κἀν μόνας χάριτας νὰ 'μολογῶ.</p> <p>Τὸ ὄποιον καθὼς λέγει ἔνας ἀπ' τοὺς παλαιοὺς.</p> <p>Εῖν' εὐγνωμοσύνης δεῖγμα κ' εἰς μεγάλους, κ' εἰς μικρούς.</p> <p>Διὰ τοῦτο καθὼς εἴπον ἐπεθύμουν νὰ λαλῶ.</p> <p>Γιὰ νὰ ἀποδώσω χάριν τῷ Δεσπότῃ τῷ καλῷ.</p> <p>Νεκταρίῳ τῷ Δεσπότῃ καὶ ποιμένι τοῦ λαοῦ,</p> <p>Πόλεως Πελαγωνείας τοῦ θεόθεν ἐκλεκτοῦ.</p> <p>Πλὴν δὲν ἔχω τί νὰ κάμω; σᾶς παρακαλῶ λοιπὸν,</p> <p>Ἀναγνῶσται, παῖδες, ἀνδρες δειθῆτε πρὸς Θεὸν.</p> <p>Ὑπέρ τοῦ Δεσπότου τούτου, ὅπου θέλει τὸ καλὸν,</p> <p>Ως φιλογενῆς ὑπάρχων, τῶν ὁμογενῶν ὑμῶν.</p> <p>ΕΤΕΡΟΝ ΤΕΤΡΑΣΤΙΧΟΝ.</p> <p>Δανιὴλ συνέγραψε με τοῦ θεοῦ ὁ Ἱερεὺς.</p> <p>Καὶ ὁ τῆς Πελαγωνείας τύπωσέ μ' Ἀρχιερεύς.</p> <p>Κ εἰς τοὺς δυώ ἔχω χάριν, καὶ τοὺς δυώ εὐχαριστῶ,</p> <p>Ο θεός νὰ τοὺς δοξάσῃ, ώς ἐγώ ἐπιποθῶ .</p>	<p>VARGJE TË MIHAİL SCHINA-S NGA LIBRI</p> <p>Desha tē kem si gjuhë tē katra gjuhët, Që tē mund tē pohoj vetëm falenderim. I cili, siç thotë njëri ndër më tē moçmit, Eshtë shenjë mirënjoheje ndër tē mëdhenj e tē vegjël.</p> <p>Andaj, siç thashë, do tē doja tē flas, Që tē shpreh falenderim ndaj dhespotit tē mirë, Dhespotit Nektar, bari tē popullit, Atij tē zgjedhur prej Tinëzot tē jetë [bari] i qytetit tē Pelagonisë,</p> <p>Tjetër nuk kam ç'bëj; veçse ju lutem Lexues, fëmjë, burra, lutjuni Tinëzot, Për këtë dhespot, që dëshiron tē mirën Si dashuror i fismë i atyre që janë tē një fisi me ju.</p> <p>KATËRVARGËSH TJETËR</p> <p>Më shkroi Dhanili, prift i Perëndisë Më shtypi Kryeprifti i Pelagonisë. U falem që tē dyve, tē dy falënderoj, Perëndia i lavdëroftë, edhe unë dëshiroj.</p>

b)

Në f. IV jepen udhëzime lidhur me mësimin e fjalorit, teksti vertikal i tē cilit, sipas autorit, ndjek si qëllim kryesor thjesht dhe vetëm mësimin e greqishtes për fillestarë, edhe pse përvojat jetësore që rroken në tē mund tē jenë më tē dobishme për lexuesin:

(IV)	
<p>Σημείωσαι, ότι τὸ παρὸν τετράγλωσσον Λεξικὸν συνετέθη μόνον καὶ μόνον διὰ νὰ συνθίσουν οἱ τῶν Μοισιδάκων παῖδες τὴν Ἦρωματικὴν γλῶσσαν. ἀφ' οὐ γυμνασθοῦν δί αὐτῷ διακεριμένως τὴν κάθε λέξιν. Θθεν ἄν ἐμπειρέχηται ἐν αὐτῷ ἡ ἔννοια ποτασή, ἡ λέξις χαμερπής, ἢς μὴ ταράττεται ὥ φυλόκαλος Ἀναγνώστης, καθ' ὁ, τι ὁ σκοπὸς τοῦ Συγγραφέως ἡτον νὰ δώσῃ μόνον εἰς τοὺς ἀπειρογλώσσους νεούς μίαν ἀπλῆν ιδέαν τῆς σημασίας τῶν λέξεων. καὶ ὅχι νὰ καμῇ διδασκαλίαν τῶν πρακτέων. Ἡμποροῦσαν δὲ νὰ διορθωθοῦν καὶ νὰ ἔμβουν εἰς ὁρθωτέραν ταξιν τὰ ἐν αὐτῷ νοήματα, δὲν εἴμεθα εἰδήμονες καὶ τῶν ἐν αὐτῷ λοιπῶν Διαλέκτων.</p>	<p>Shënoj se ky fjalor në katër gjuhë u hartua vetëm dhe vetëm, që fëmijët e Mesodakëve [= vllehäve] të përditësohen me gjuhën e romejve, pasi do të jenë ushtruar në mënyrë të veçantë - me ndihmën e tij - me çdo fjalë; të mos turbullohet lexuesi i mirë, nëqoftëse fjalori përmban kuptime të rëndomta, në mos fjalë të përgjithshme, sepse qëllimi i autorit ka qenë vetëm dhe vetëm t'u japë të rinjve që s'e njohin gjuhën [e romejve] një ide të thjeshtë mbi kuptimin e fjalëve, dhe jo të japë mësim të mirëfilltë. Ndërkohë kuptimet në vetvete mund të ishin përmirësuar dhe ngërthyer në rend më të drejtë, po të ishim njohës edhe të dialekteve të tjera.</p>

c)

Në f. V-VI pasqyrohet nëpërmjet vargëzimit alfabeti greqisht, ku çdo varg nis me shkronjën greqisht të radhës. Në këto vargëzime, sidomos në pjesën e parë autorri -ndoshta Mjeshtër Dhanili (?)¹ - kumton si dëshirë dhe qëllim final helenizimin e të krishterëve ortodoksë jogreqishtfolës:

ΣΤΙΧΟΙ ΑΠΛΟΙ ΚΑΤΑ ΑΛΦΑΒΗΤΟΝ ΑΝΕΠΙΓΡΑΦΟΙ.	VARGËZIME TË THJESHTA NË REND ALFABETIK
<p>Ἀλβανοί, Βλάχοι, Βούλγαροι. Ἀλλόγλωσσοι, χαρῆτε, Κ' ἔτοιμασθῆτε. ὥλοι σας, ΅ματοι νὰ γενῆτε. Βαρβαρικὴν ἀφήνοντες γλῶσσαν. φωνὴν, καὶ ἥθη.</p> <p>Ὀποῦ στοὺς Ἀπογόνους σας νὰ φαίνωνται σᾶν μῦθοι. Γένη σας νὰ τιμήσετε, ὅμοι καὶ τὰς Πατρίδας. Τὰς Ἀλβανοβουλγαρικὰς κάμνοντες Ἑλληνίδας. Δὲν εἶνεν πλέον δύσκολον, νὰ μάθετε ΅ματά.</p> <p>Καὶ νὰ μὴ βαρβαρίζετε μὲ λέξεις πέντε δέκα. Ἐχετε εἰς τὰ χέρια σας, συχνὰ καὶ μελετάτε. Τὸ νεοτύπωτον αὐτὸ βιβλίον ὃπου πάτε. Ζητήματα νὰ εὔρετε ὅσα ἐπιθυμεῖτε. [θῆτε. Τὴν γλῶσσαν τὴν ΅ματικὴν καλὰ νὰ γυμναστήτε. Ἡτον ἀναγκαιότατον νὰ ἐκδοθῇ εἰς τύπον, Τὰ γένη σας νὰ τιμηθοῦν μὲ τοῦτο καθὼς ἔπον. Θερμῶς λοιπὸν προσέχετε εἰς τὴν ἀνάγνωσίν του,</p>	<p>Shqiptarë, vllehä, bullgarë, folës gjuhe tjetër, gëzohuni dhe përgatituni të gjithë, të bëheni romej. Duke braktisur gjuhën barbare, tingëllimin dhe zakonet, [në mënyrë] që stërnipërve tuaj t'u duken si përralla. Do të nderoni farën dhe atmet tuaja [duke u shndërruar nga albano-bullgarë në helenë, Sepse nuk është aspak e vështirë të mësohet romajka [dhe të mos flisni si barbarë pesë a dhjetë fjalë. Ta keni në duart tuaja, dhe ta studioni shpesh, kudo ku shkoni, këtë libër, të porsashypur. Të kérkoní sa të doni dhe të mësoni mirë gjuhën romajke. Ishte i nevojshëm botimi që të shtypej, [me</p>

¹Vëmë pikëpyetje pa forcë argumenti, por thjesht me mbajtur parasysh vargjet 20-21 (nga poshtë), ku shkruhet në vetë të tretë me lëvdata të rastit për Mjeshtër Dhanilin si hartues i tekstit mësimor.

<p>Μή άκριβολογούμενοι γιά τὴν ἀπόκτησίν του, Ιδέας ν' ἀποκτήστε πραγμάτων διαφόρων. Τὸν νοῦν σας καταστήνοντες γόνιμον καρποφόρον. Κλέος νὰ προξενήστε δῖοι στὸν ἔαυτὸν σας, Ἐν μέσῳ τῶν λοιπῶν ἔθνῶν καὶ τῶν ὄμογενῶν σας. Λαοὶ οἱ πρὶν ἀλλόγλωσσοι, ἀλλ' εὔσεβεῖς τὰ θεῖα, Ῥωμαίων ν' ἀποκτήστε γλῶσσαν καὶ ὄμιλίαν. Μεγάλως ὠφελούμενοι εἰς τὸ ἐπάγγελμά σας, Κ' εἰς ὅλα τὰ ἡμιτορικὰ ἐπιχειρήματά σας. Νέοι Βουλγάρων χάρετε, Ἀλβανιτῶν, καὶ Βλάχων, Διάκονοι, Πρεσβυτεροί, μεθ' Ἱερομονάχον. Ευπνίσατε ἀπ' τὸν βαθὺν ὑπνὸν τῆς ἀμαθείας. Ρωάκια γλῶσσα μάθετε, Μητέρα τῆς σοφίας. Οἱ μοισιόδαξ Δανιὴλ ἔντιμος Οἰκονόμος. Τὴν βίβλον ἐξεπόνησεν, ὃν Ἱερεὺς ἐννόμως. Πελαγωνείας δ' ὁ καλὸς ποιμὴν καὶ Ἱεράρχης. Τύποις αὐτὴν ἐξέδωκεν, ὡς θεῖος πομενάρχης. Ῥωμαϊκαὶ γλῶσσα θέλωντας τοὺς πάντας νὰ διδάξῃ. Καὶ τὰ Βουλγαραλβανικὰ ἥθη νὰ μεταλλάξῃ. Στολίζωντας τοὺς τόπους σας, καὶ συνιστῶν Σχολεῖα. Καὶ μὲν Ρωμαϊκαὶ γράμματα γυμνάζων τὰ παιδία. Τοῦτον λοιπὸν τὸν ζηλωτὴν καλὸν Ἀρχιερέα. Νεκτάριον τὸν Βιθυνὸν μὲν γύγνωμοστὸνης χρέα. Ὑμεῖς π' ἀπολαμβάνετε διηνεκῶς τὰ δῶρα, Πρέπει ναύχαριστήστε προθύμως πάσῃ ὥρᾳ. Φυλάττοντες ὑποταγὴν εἰς τὰ προστάγματά του, Καὶ σέβας, καὶ εὐλάβειαν εἰς τὰ ἐνταλματά του. Χάριτας νὰ γνωρίζετε εἰς τὴν ποιμαντορίαν, Ποὺς σᾶς ἡξίωσ' ὁ Θεὸς, τὴν δοντως σεβασμίαν. Ψυχῶν τὴν σωτηρίαν σας, θεόθεν ἐξαιτοῦντες, Καὶ τὰ εὐάρεστα αὐτοῦ, τῷ νεύματι ποιοῦντες. Ωφέλειαν βιωτικὴν νὰ εὑρῆτε μεγάλην, Καὶ ἀγαθὰ αἰώνια εἰς τὴν ζωὴν τὴν ἄλλην.</p>	<p>qëllim që fara juaj të nderohet me të, siç thashë. Ndaj me kujdes dhe zjarm librin ta lexoni dhe ju që s'jeni aq të aftë e gjuhën nuk zotëroni. Të zotëroni dije për çështje gjithfarë, Mendjen ta shndërroni në tokë pjellore. Krenari të bëheni për veten tuaj, fiseve të tjerë dhe mes gjakut tuaj. Popuj, të tjetër gjuhe, por me shpresë tek hyjni, përvetësojeni gjuhën dhe të folmen e romjeve. Duke e përdorur në zanatin tuaj, dhe në të gjitha ndërmarrjet tuaja tregtare Gëzohuni rini e bullgarëve, shqiptarëve dhe e vllehëve, Diakonë, priftërinj dhe jeromonakë. Zgjohuni prej gjumit të thellë të mosdijes. Mësoni gjuhën romajke, mëmën e urtësisë. Mesiodaku Dhanil, ikonomi i nderuar, Këtë libër hartozi, si prift i shuguruar. Por bariu i mirë dhe hierark i Pelagonisë, e dha për shtyp, si një kryebari hyjnor. Duke dashur të mësojnë të gjithë gjuhën romajke dhe të ndryshojnë zakonet bullgaro-shqiptare. Duke zbuluar vendin tuaj dhe duke hapur shkolla dhe duke mësuar fëmijët me shkronjat romajke. Prandaj këtij arhiereu të mirë dhe të zellshëm, Nektarit nga Bitinia, duhet t'i jemi mirënjohnës, prej atij merrni dhurata pa pushim. Në çdo kohë ta falënderoni dhe me dëshirë. Duke ruajtur me përulje porositë e tija, dhe [me] respekt dhe devotshmëri urdhëresat e tija. Hiret të kuptioni prej këtij bariuvërtet tërespektuar, me të cilin ju denjësoi Zotynë. Shpëtimin e shpirtrave tuaj, Tënenzoti, t'i kërkoni. Të pëlqyerat prej tij, me shpirt t'i zbatoni. Që të gjeni dobi në këtë jetë dhe të mirat e amëshuara në jetën tjetër.</p>
--	--

3. Fjalësi shqip në fjalorin katërgjuhësh të Dhanilit

Siç përmendëm edhe në fjalët hyrëse të punimit tonë, fjalësi shqip, në të cilin jemi fokusuar në studimin tonë, është pjesë e fjalorit katërgjuhësh në tekstin shkollor të Mjeshtër Dhanilit (f. 1-36) dhe ngërthen si i tillë pjesën e parë të këtij teksti, e konceptuar kjo së paku

si fazë e përvetësimit paraprak të greqishtes si gjuhë komunikimi në shkollë (edhe) për rishtarë të bashkësive të tjera gjuhësore etnike në terrenin ortodoks. Duke synuar në këtë pjesë sendërtimin e një koncepti të mirëfilltë pedagogjik sic është paraprakisht përvetësimi i greqishtes së paku si mjet komunikimi në shkollë, autori përzgjedh në këtë model ligjérimin e thjeshtë në secilën gjuhë. E ndërsa kjo përzgjedhje për gjuhë të tilla me lëvrim të mangët si arumanishtja, bullgarishtja dhe shqipja ishte si të thuash pa opzion alternativ, përzgjedhja e greqishtes populllore, përkatësisht e formës së saj në ligjérimin e thjeshtë i shkon bash përshtat konceptit didaktik të librit mësimor në vetvete, më saktë të lëndëve të ndryshme që rrroknin formimin humanist dhe atë liturgjik ortodoks në shkollat greqisht të kohës.

Parë nga kjo perspektivë, nuk kemi përsë bëjmë aspak çudi që vetë fjalori katërgjuhësh nuk është organizuar në formën klasike të një fjalori shumëgjuhësh, ku fjalët a lemat e izoluara në secilën gjuhë vijnë e përqasen me njëra-tjetrën për t'u mësuar më pas përmendësh prej nxënësve në mënyrë individuale ase në kor gjatë orëve të mësimit (si p.sh. Kavalioti 1770; Kodiku Beratas, gjysma e dytë e shek. XVIII, f. 75-76; 87-102), por sendërtonte dukshëm dhe bindshëm një model didaktik komunikimi intensiv brenda një grupei gjuhësor heterogen nxënësish të një grupmoshe, duke mbarështuar gjithherë në sfond e si i tillë synimin: përvetësimi i greqishtes si gjuhë komunikimi në shkollë, përkatësisht me vizionin afatgjatë që ishte zotërimi i saj si gjuhë prestigji kulturor-intelektual e që mundësonte e vetme formimin humanist dhe fetar, përkatësisht përqafimin e natyrshëm dhe me bindje të helenizmit sikurse edhe të besimit ortodoks bizantin si shkallët më të larta të qytetërimit universal dhe të besimit kristian njëherësh.

Asgjëmangut, edhe teksti shqip në këtë fjalor është rrokur e realizuar shi si pjesë e këtij modeli didaktik, duke përcjellë kështu shqipen e folur në ambientet ortodokse të kohës, anipse nuk jemi larg së vërtetës po të pohojmë rishtas që Mjeshtër Dhanili duhet të ketë qenë njohës dhe zotërues i patëmetë, por jo patjetër folës nativ i saj. Për nga përmasat që ka si tekst i lidhur, ky material gjuhësor përbën edhe tekstin e dytë më të gjatë në kulturën ortodokse të shkrimeve të vjetra shqip me alfabet greqisht në jug të hapësirës kompakte shqipfolëse, pas atij në Kodikun Beratas (Demiraj 2019a). Por jo vetëm

kaq: vetë koncepti didaktik i ndërtimit të fjalorit katërgjuhësh si tekst i lidhur që mbulon fusha ndër më të ndryshmet në jetën e përditshme dhe të përvojës jetësore në shtresat e thjeshta urbane dhe rurale të mjediseve ortodokse të kohës e rrit shumëfish vlerën e këtij teksti në trashëgiminë e hershme të shkrimit shqip brenda këtij areali, ku deri në fund të shek. XVIII mbizotërojnë tekstet liturgjike fetare ase sosh që janë në funksion të mbarështimit të besimit ortodoks kristian.¹

4. Kodi alfabetik dhe rregullat e leximit të tekstit shqip

Një vëzhgim sado i përciptë i gjithë tekstit shqip të rrrokur në fjalor lejon t'i bashkohemi pa hezitim aradhës së studiuesve filologë që janë marrë deri sot me përshkrimin e librit mësimor të Mjeshtër Dhanilit, përkatesisht me interpretimin dhe botimin kritik (edhe) të materialit shqip në atë fjalor, të cilët mëtojnë me të drejtë se sistemi grafik në pasqyrimin e atij materiali përcjell mirëfilli atë traditë dhe variacion në kulturën e shkrimit shqip me alfabet grek që mbizotëron në botimet dhe dorëshkrimet poliglote të kohës me destinacion Arealin Kulturor të Jugut ortodoks, (Terpo 1731; Kodiku Beratas shek. XVIII) ku feks sidomos fjalësi shqip në fjalorin trigujuhësh të mjeshtrit të tij Anastasiu Kavalioti (1770). Prashtu, kjo vijimësi në kulturën e shkrimit shqip me alfabet grek sendërtohet në tekstin në fjalë si në njohjen dhe përvetësimin e kodit alfabetik, ashtu edhe në zbatimin në përgjithësi të të njëjtit aparat ortografik që përdornin atëbotë autorët shqip- dhe arumanishtfolës në arealin në fjalë. Le të ndalemi paraprakisht në pasqyrën e kodit alfabetik dhe të aparatit ortografik të zbatuar në të, bash ashtu siç kemi mundur ta qëmtojmë dhe klasifikojmë gjatë punës për digitalizimin e dorëshkrimit shqip.

Tabela e mëposhtme përcjell në mënyrë pak a shumë të sistematizuar fondin e grafemave me kombinimet e tyre në kod (kol. III: MDH = *Mjeshtër Dhanili*) së bashku me vlerat tingullore (kol. I: IPA = *International Phonetic Alphabet*) dhe shembujt përkates në dorëshkrim (kol. IV). Për një orientim më të mirë në lexim vlen sigurisht edhe përqasja me listën e grafemave gjegjëse në alfabetin e Manastirit (kol. II: MAN = *Alfabeti i Shqipes Standarde*), si vijon:

¹ Hollësi për përbajtjen dhe fushat leksikore që shfaqen në fjalor së bashku me krehjen e materialit analistik në letërsinë shkencore ka ndërmarrë Lloshi 2006 94 vv.

IPA	MAN	DAM	Shembuj DAM
[a]	a	α	δαλλ [ðaɫ], ḡ πωγάτ [i bo'gat], τά ᷑ απσσ [tə apʃ], χ᷑ [ha]
[b]	b	μπ π	μπάρη [‘bərī], μπορίκα [bo'rikə], τα βέρμπαρατ [ver'bərət] μπηπήλατ [bil'bilat], βραπέτζατ [vra'becat]
[ts]	c	τζ	τζά [tsa], κάτζατα [‘kəcatə], μπουαλίτζα [buɑ'litsə]
[tʃ]	ç	τζ	πλώτζα [‘płotʃa], τζεκύτζητ [tʃe'kitʃit], μαλτζίτ [məl'tʃit]
[d]	d	ντ τ	ντρίθα [‘driθə], κουντώ [ku'do] τέτνα [‘detnə], τουάλλα [‘duaɻə], τρούρατ [‘drurət]
[ð]	dh	δ	έδε [e'ðe], δέντα [‘ðentə], δητα [‘ðitə]
[e]	e	ε αι	χεκουρ [‘hekur], έδε [e'ðe], ή τέρτζημ [i 'n)derçim] βέκαητ [‘vejet], μπάχεται [‘bəhetə] (~ [‘bəhetə])
[ə]	ě	ᾳ (α) (ε) *αι	Περφατία [perə'ndia], Παρσαρή [pərsə'rī], τάσιελ [tə sjeɫ] ούρδαρόη [uðə'rōi], κόχατ [‘kohət]... εστα [‘estə], γκά ποῦννε [‘punə], ζέ [zə], ε σαϊε [‘sajə] μπάχεται [‘bəhetə]
[f]	f	φ *υ	φούσσα [‘fuʃə], στρώφκα [‘s/strofka], φόρτ [fort] γκικαύσσ [ji'kaʃ]
[g]	g	γκ γ-Α/С (κ) (*κκ)	γκωμάρατα [go'marətə], γκούρ [gur] ζαγμέτ [zag'met], μεριμάγα [meri'maga], γιοργάνα [jor'gana] μπακατίτα [bagə'titə], έκρατήρατ [egrə'tirat], κρούρα [‘grurə] τέκκα [‘dega]
[ɟ]	gj	γγ-Ε *γ-Ε γκ-Ε γκι-Α (κ-Ε) (κι)	γγέλαννα [‘jeɻənə], ταγγίθα [tə 'ɟiθə] τα βεγηλιτ [tə 'vejilit] (~ τε βέκιλ [tə 'vejil]) γκίθα [‘ɟiθə], γκίζα [‘ɟizə], τά μέγκηρτ [tə 'məjnirt] γκιόληρατ [‘jolirat], γκιάλπ [jalp], γκιουνάχετ [ju'nahet] κέντεννα [‘jendenə], κῆ [ji], κελπέρανα [jel'perenə] κιάθ [jaθ]
[h]	h	χ	χίθρατ [hiθrat], χάεν [‘haen], ιχτιζα, σπρήχα [‘spriha]
[i]	i	ι υ η *ει	ννυκίντ [ni'cint], ιχτιζα [ih'tiza], μίσαρ [‘misər] τακυρούαρα [tə 'ciruarə], φυτίμη [fi'timi], Ννῦ [ni] αρήου [a'riu], μήρα [‘mirə], ζαήρε [‘zaire], ἀη [a'i] παραδείσνα [para'ðisnə]
[ɯ/j]	j	γι	ιούγιετ [‘yjet], γιάννα [‘janə], γιάβα [‘javə], δγιέτ [ðjet]

		η ϊ ι	καρκόηννα [kər'kojnə], μπάηνα [mbajnə], μούαη ['muaj] πουνόϊχ [pu'nojnə], οῦκου ['ujku], κούαϊτα [kuajtə] ιαννα ['janə], τατιέρα [tə'tjera], πιέλνα [pjēlnə]
[k]	k	κ-Α κκ-Ε	κούρ [kur], καρκόηννα [kər'kojnə], θέκαρ [θekər] κκέκη [keq], τέκκ [tek] κιέμη [kemi], ρακκί [ra'ki]
[l]	l	λ-Ε/Σ λι-Α λλ(ι)	πλέπη ['plepi], σσέλκου ['selku], τάληνα ['dalina] λιούμφρωτ [lumφrat], πλιότ [plot], λιούλετα ['luletə] γκιάλλιατα ['njalatə], πούλλιατα ['pulatə]
[ʎ]	ll	λ λλ	κίελτ [ciełt], Ασλανη [as'lanı], πιέλνα [pjēlnə] τίελλανα ['diełnə], γκέλλα [jełə], πιούλλ [pył]
[m]	m	μ *μμ	μάλετ ['malet], σσοῦμα [sumə], μπουλμέτ [bul'met] σσοῦμμα [sumə], πέμμα ['pema], λέμμα ['lemə]
[n]	n	ν νν	νούκα ['nukə], ρούαν ['ruan], γιάνα ['janə] κέντεννα ['jendenə], γιάννα ['janə], πᾶμάρννα [marınə]
[ɲ]	nj	*ν *νι νν ννι	τά γκιούαν [tə 'juajn], τα γκίζην ['njizijn], νιμπαδγιέτ [ni...] ντουνιάϊα [du'naja], νιερίνα [ne'rīna] ννηζέτ [ni'zet], τά σκόνν [tə ūkon], ννί [ni], ντένν [ndeñ] ννιερήτου [ne'riut], ταννιόχτουρ [nohtur], τα γνιόμ [nom]
[o]	o	ο ω	περόνα [pe'rona], λιολέκατ [lo'lekat], βόζατ ['vozat] κώχα ['kohə], πῶ [ro], κατῶ [kə'to], φώλέτ [folet]
[p]	p	π	πλέπη ['plepi], παρπράπα [pər'prapa], γκιάλπ [jalp]
[c]	q	κι/η κ-Ε °κκι/η *κκ *-κ"	κιούμφασστ ['cuməʃt], πλέκιτα ['plektə], κκέκη [keq], κίελτ [ciełt], πέσκιτ ['peſkit], σκέρωτα ['ſcerata], κή [ci] μίκιητ [mict], ζώκκι [zoq], κόκκιε ['koce], φουκκή [fu'ci] πλέκκτα ['plektə], κούκκεα ['cycea], φύκκ [fic] πέσκ [peſc] (?)
[r]	r	ρ *ρρ	δέλπαρα ['ðelpəra], κούρ [kur], κρούα ['krua] βέρρα [verə], βούρρα [vura], καλκέρρα [kəl'cerə]
[r̩]	rr	ρρ ρ	σωρρα ['sora], ἄρρα [arə], μόρρα ['mora] ρόιμα ['rojmə], ρήνα ['rinə]
[s]	s	σ	σήπαρ ['sipər], βῆσε ['vise], πάσ [pas], σπρήχα ['sprīha]
[ʃ]	sh	σ-Σ σσ	πέσκιτ ['peſkit], τούσκου ['duſku], μίσρατ ['mīſrat] σσέλκου ['selku], πρήσσινα [priſinə], λέσσ [leſ], չստա
[t̪]	t	τ	κατῶ ['kəto], μήτα ['mitə], στάτα κίντ [statə'cint]
[θ̪]	th	θ	θᾶ [θa], θέκαρ [θekər], γκίθα ['jiθə], χίθρατ ['hiθrat]

[u]	u	γ = ου	δέου ['ðeu], τροῦ [dru], μπούκουρ ['bukur], οὔτ [ujt]
[v]	v	β (υ)	σελβῆς [sel'vie], βῆσε ['vise], βέρβαξ ['verə] (γκικαύσσ [ji'kaʃʃ])
[dz]	x	τζ	ντζούαρα [‘ndzuara], ντζέ [ndze], ντζιτώεσσ [ndzito'eʃ]
([dʒ])	(xh)	τζ	πεντζέρετ [pen'dzeret], κοτζα'πάσσιτα [kodza'bajitə]
[y]	y	ιου ου	ιούγιετ ['yjet], ἀστιοῦ [aʃ'ty], πιούλλ [pyl], τιού [dy] κούκκεα ['cycea], κρούετ ['kryet],
[z]	z	ζ	ζεμαρήμ [zemə'rɪm], καντέζη [kən'dezi], μίζα ['miza]
[ʒ]	zh	*ζ	μρέζα ['mreza]
[ks]	ks	ξ	(mungon)
[mb]	mb	μπ	μπή [mbi], μπάγνα [‘mbajnə], τάμπιελνα [mbjełnə]
[mp]	mp	μπ	τά πρέμπτενα [tə prem'ptenə] +ού μψέε [u 'mpse.e]
[nd]	nd	ντ	ντά [ndə], βεντη [‘vendi], τούντ [tund], τέντε [‘tände]
[ng]	ng	γκ	γκρέ [ngre], γκά [nga], λέγκ [leng], τα γκόπεννα [‘ngopenə]
[nj]	nj	γκ(ι)	γκιάλλιατα [‘njalatə], μαγκέσ [mən'jes], τὴ γκίτζ [t̪i njitʃ]
[nt]	nt	ντ	νάντα [nənτə'cind], δέντα ['ðentə]
[nn]	njn	νν	τα ντίεννα [tə 'ndiejnə], φσήννα [‘ffjennə], βγιέννα ['vjejnə]
[nt]	njt	ντ	ταέντενα [tə 'ejtenə], ταρήντ [tə rjnt], φκίντα [fcijntə]
[ps]	ps	ψ	ντῶταπροκόψ [pro'kops], ψέ [pse], ύψωμ [i'psom]
[pʃ]	psh	ψ πσ(σ)	τάστιούψ [təstypʃ], ού μψέε [u 'mpse.e] τά ἄπσσ [tə apʃ], πστούμραρετ ['pʃtumrat]
[st]	st	Σ = στ	παστάη [pas'taj], καφάστ [ka'fast], ποστάφ [po'staf]
[ʃt]	sht	Σ = στ σστ	τά στιούψ [tə stypʃ], κάστα [‘kaʃtə], ἀστιοῦ [aʃ'ty] κιούμασστ [‘cuməʃt], Τέσστα [‘deʃta], πώσστ [poʃt]

4.1. Sqarime të rastit

Tabela e mësipërme nuk mëton një ezaurim të plotë sidomos të bashkëlidhjes së shkronjave dhe/ose grafemave në varg që ndikon në një rast a një tjetër rregullat e leximit të rrjedhshëm në grafitë përkatëse. Gjithashtu, për arsyet më fort teknike, nuk është rrokur në tabelë inventari i plotë i ligaturave, sikurse përdorimi i *jota subscriptum* dhe i *hyphen*, që shënojnë shqiptimin e lidhur në një numër togtingujsh me rregullat fonotaktike përkatëse, bash ashtu siç jemi përpjekur t'i përcjellim me besnikëri në riprodhimin diplomatik të fjalorit. Tabela i mundëson gjithsesi lexuesit të njohë nga afér dhe në mënyrë të sistematizuar, inventarin e grafemave me tiparet e tyre kryesore nyjëtimore si edhe atë variacion grafik brenda kodit alfabetik që ofron si i tillë fjalësi shqip qoftë në vetvete ashtu edhe në përgjasje me traditën e vyer të shkrimit shqip me alfabet grek në Arealin Kulturor të Jugut ortodoks në shek. XVIII-XIX. Prashtu vëmë oroe ndër të tjera, që:

a. Fondi i shkronjave dhe i varianteve grafike të përdorura si të tillë në tërë tekstin, bazohet fund e krye në alfabetin greqishtes me gjithë-gjithë 24 shkronja, khs.: < α β γ δ ε ζ η θ ι κ λ μ ν ξ ο π ρ σ τ υ φ χ ω >. Përdorimi i tyre (edhe) në tekstin shqip kushtëzohet në përgjithësi me shqiptimin, përkatësisht rregullat e leximit të tyre në greqishte, khs. ndër të tjera edhe zanoret: [i] = /i/ = <ηι> dhe [o] = /o/ = <ο ω>; dysitë fonemike: [ks] = /ks/ = <ξ> dhe [ps] = /ps/ (pranë /psh/) = <ψ>; sikurse edhe ligaturat me vlerë fonemike të stabilizuar qysh në greqishten kishtare dhe atë të kohës, khs.: <ς = στ> = [st] = /st/ (pranë /sht/); <γ = ου> = [u] = /u/ (khs. Terpo 1731, Kavalioti 1770 etj.).

b. Zgjidhje të tjera grafike që Mjeshtër Dhanili i ka marrë të gatshme prej kodit grafik të greqishtes, përkatësisht prej traditës së shkrimit shqip me alfabet greqisht, rezultojnë të mos kenë qenë gjithherë fatlume, meqë mundësojnë lexime ambigue. Këtë rrethanë e ndeshim në mënyrë të përsëritur në pasqyrimin grafik të mbylltoreve të zëshme /b d/, që në shkrimet shqip të kohës realizohen edhe me njëshkronjëshat <πτ> krahas digrafeve <μπντ>, por që në tekstin shqip i lexojmë sipas rastit edhe si togje bashkëtingëllorësh /mb mp nd nt/. Gjithsesi si në këtë rast, ashtu edhe në raste të tjera që lidhen me leximin korrekt të tekstit e kemi shumë më të vështirë me përsiatur

variacione reale në ligjërimin e thjeshtë të asaj kohe, përkatësisht në mënyrën e përjetimit të tyre prej autorit joshqipfolës të vetë fjalorit.

c. Një rrethanë të tillë, për ne sot krejt të pazakonshme, paraqet edhe leximi i rregullt i grafemës gr. <δ> si [ð] edhe për njësi leksikore si shq. *djalë*(krahas *dbohet*), që në tekst na shfaqet me grafinë <διάλλε> = /dhjalë/ (31 26) ~ διέμτᾳ /dhjemtë/ (9 6). Kësot rasash – edhe pse jo pa vrasamendje! – nuk kemi ndërhyrë në tekst, duke menduar se mund të jetë pjesë e variacionit gjuhësor në ligjërimin popullor (tek arumunët ?), qoftë edhe për të shmangur homoniminë me *djall*.

d. Vështirësi jo të paka shoqërojnë leximin e rrjedhshëm të tekstit shqip edhe funksioni bi- deri polivalent i disa grafemave të thjeshta dhe/ose të përbëra, të cilat nuk lidhen drejtpërdrejt me rregullat (orto)grafike të greqishtes së kohës. Siç i kemi fiksuar edhe në vendet përkatëse në tabelë, dysi leximi lejon p.sh. përdorimi i disa grafemave bashkëtingëllore, si p.sh.: <π> për /p ~ b/, <τ> për /t ~ d/, <σσσ> për /s ~ sh/, <τζ> për /c ~ x ~ ç ~ xh/ etj.

e. Asgjëmangut një numër aspak i vogël problemesh ortografike ka të bëjë edhe me do tinguj me funksion kuptimdallues (fonema) të shqipes së kohës që janë të huaj në sistemin fonetik të greqishtes: khs. /ě y ll rr/ = [ə y l r]. Pikërisht në këto raste përjetojmë në lexim ndërhyrjet e vetëdijshme të Mjeshtër Dhanilit, i cili përdor disa përvoja zgjidhjesh grafike në kod që nuk janë gjithnjë fatlume.

- Përdorimi i shkronjave <ι/η> si mjet grafik për të shmangur leximin e gabuar në ato rasa kur shqiptimeve alofonike të së njëjtës fonemë në greqishte i përgjigjen në shqipe dy tinguj të ndryshëm me funksion kuptimdallues (fonema), khs. shq. /k ~ q/ = [k ~ c] = <κ-Α> vs. <κι/η> = [k ~ c], ndërsa proporcione të paqëlluara i hasim në dysitë e fonemave shq. /g ~ gj/ e /n ~ nj/ kundrejt gjegjëseve alofonike gr. <γ-Α ~ γ-Ε> = /g/, <ν-Α ~ ν-Ε> = /n/ (sh. në tabelë).

- Si mjet grafik nuk mund të vlerësojmë gjithherë dyfishimin e shkronjave (<λ(ι) ρ> (/l r/ ~) <λλρρ> për shq. /ll rr/, d.m.th. për dy tinguj të tjerë rezonantë me funksion kuptimdallues që nuk njihen si të tillë në greqishte.

- Për përdorimin e *jota subscriptum* si mjet grafik sh. më poshtë pikën g.

- Për përdorimin e *hyphen* si mjet grafik sh. më poshtë pikën j.

f. Zanorja /e/ paraqitet grafikisht rregullisht me *epsilon*-*ɛ* dhe në dy raste sporadike edhe me digrafin <αι/η>; sh. poshtë pikën g.

g. Paraqitja grafike të fonemës zanore /ë/ si fonemë pa gjegjëse në greqishte, është sigurisht më e larmishmja meqë ka frekuencë të lartë, nyjëtim të variueshëm dhe gjegjëse në greqishte. Rrethana të paraqitjes së saj grafike pritej megjithatë të mos ishin aq të komplikuara meqë në arumanishte kjo zanore nuk është aspak e huaj. Kështu që lejohemi të sistematizojmë paraqitjen e saj grafike si vijon:

- <α>: Shkrimi i saj me shkronjën *alfa* dhe *jota subscriptum* si mjet grafik është i rregullt në tekst, sikurse edhe në fjalorin e Kavaliotit.

- <α>: Jo rrallë ndeshim në fjalësin shqip vetëm *alfa* të thjeshtë, pikërisht aty ku pritet të kemi zanoren qendrore /ë/. Asgjëmangut kemi të bëjmë me harresa të rastit, qoftë prej autorit në dorëshkrim, qoftë prej radhitjes së tekstit në shtypshkronjë. Lajthitje të kësaj natyre i përjetojmë sot e gjithë ditën me shkrimin e pakontrolluar të grafemës <ë>pa *tremë* në shqipen letrare.

- <ε>: Në shumë raste ndeshim në tekst edhe shkronjën *epsilon* aty ku pritet shkrimi me <α>: Denduria e përdorimit është e tillë saqë është vështirë të operohet me lajthitje në shkrim të autorit. Pas gjithë gjasash kemi të bëjmë me një variacion zanor në ndërgjegjen gjuhësore të autorit, si arumanishtfolës i zonës, ku zanorja qendrore /ë/ = arum. <ă> ndërndërrohet shpesh me /e/ (Capidan 1929-30 171¹)

- Kjo rrethanë do të përcillet si e tillë në transkriptimin e tekstit shqip. Ndërsa në variantin e tekstit të normalizuar do të veprohet sipas ndërgjegjes (së sotme) gjuhësore të popullsisë shqipfolëse të zonës.

- <αι>: Në këtë kuadër do të veprohet edhe me rastin e vetëm në tekst ku na shfaqet digrafi <αι> = /e/ (~ /ë/).

- Raste të tjera të variacionit grafik dhe gjuhësor do të përcillen me shpjegime të rastit në rubrikën “Shënime” (§5.3) që përmbyll punën kryesore të studimit tonë lidhur me riprodhimin diplomatik dhe transkriptimin e zgjeruar të tekstit burimor.

h. Shumësia e paraqitjes grafike të zanores /i/ në greqishte, shfrytëzohet rregullisht në tekst me shkronjat <i, u, η> dhe vetëm në një rast me <ει>.

¹Sh. më poshtë edhe §5.3 51b.

- i. Zanorja /y/ paraqitet rregullisht në tekst me trishkronjëshin <iou>; rrallë e me argument interpretimi filologjik edhe me <ou>.
- j. Bashkëtingëllorja /j/ (= glide) pasqyrohet në tekst në disa mënyra <γι, η, ι, ι> pa shpërndarje distribucionale grafike të dukshme. Përndryshe, përdorimi i *hyphen* si mjet grafik na shfaqet vetën ë këtë rast.
- k. Në paraqitjen grafike të lëngëtores së thjeshtë /l/ vërehet deri diku një shpërndarje distribucionale: <λ-E/C> ~ <λι-A>, e në trup të fjalës në raste sporadike dyfishimi <λλ(ι)>.
- l. Lëngëtorja /ll/ është në të kundërtën grafikisht e paqëndrueshme: <λ, λλ> e ka të bëjë jo vetëm me variacionin dialektor të shqipes në ato zona (si toskërishte verilindore), por edhe me ndjesinë gjuhësore të autorit si folës nativ i arumanishtes. Kjo situatë vërehet edhe në paraqitjen grafike të vibranteve /r/, /rr/, ku dyfishimi <ρρ> vs. <ρ> ndërndërron vendet në mënyrë të parregullt.
- m. Problematikë e ngjashme karakterizon edhe paraqitjen grafike të hundores /nj/, e cila në shumë raste kolidon me hundoren /n/: <*v, *vι, vv, vvi>. Ky problem në dukje i natyrës grafike ndërlifikset a) së në radhë të parë në ndërgjegjen gjuhësore të autorit, si folës nativ i arumanishtes, ku kjo fonemë (sikurse në greqishte)mungon, por b) do mbajtur parasysh edhe përvetësimi prej tij i variacionit dialektor të shqipes së trevave toske verilindore sidomos i atij në sistemin foljor, ku ndërndërrimet ndërmjet tingujve /j/ ~ /nj/ ~ /n/ brenda paradigmave përkatëse herë-herë nuk lejojnë një hulumtim të patëmetë të realitetit gjuhësor të kohës në këto treva. Probleme të rastit, që jo gjithmonë përjetojnë zgjidhje fatlume, jemi rreku r'i shqyrtojmë në veçanti në rubrikën “Shënimë” (§5.3)
- n. <ç> = */-s/ nuk shfaqet asnjëherë në tekst me funksionin e saj zanafillës në pozicion fundor.

Sic rezulton edhe nga kjo dorë vërejtjesh të thukëta të rreshtuara më lart, kodi alfabetik në tekstin shqip të fjalorit të Mjeshtër Dhanilit dëshmon një prirje të theksuar drejt shkrimit fonetik, i cili në kushtet e mungesës së një tradite të lëvruar mirë në kulturën e shkrimit shqip në këtë areal e rrit mjaft propabilitetin e variacionit gjuhësor individual e që është parashikuar të shtjellohet në detaj në një punim tjetër, ku janë parashikuar përqasje sistematike me kodin alfabetik të mjeshtrit dhe patriotit të tij, Anastas Kavaliotit (1770).

Së fundi edhe dy fjalë për shenjat e pikësimit dhe rregullat ortografike në tekstin shqip të librit mësimor me autor Mjeshtër Dhanilin: Në inventarin e mjeteve grafike që përdor autori në tekst bën pjesë si shenjë pikësimi vetëm pika. Si ndikim i ortografisë së greqishtes do parë padyshim përdorimi i dendur i theksave, lloji dhe ndërndërrimi i shpeshtë i të cilëve (*: i mprehtë ~ i rëndë ~ majérrethor*) pas gjase nuk luan asnijë rol të natyrës fonetike ortografike në tekstet shqip, përpos dallimit të rrokjes së theksuar. Probleme aspak të vogla shoqërojnë në këtë pikë edhe riprodhimin diplomatik të teksteve gjegjës greqisht e arumanisht, ku në shumësi rastesh është vendosur *ad hoc* përdorimi i njërit apo tjetrit theks. Siç kemi qartësuar edhe në vëzhgimet redaksionale lidhur me riprodhimin diplomatik të teksteve greqisht e shqip, nuk janë ndërmarrë në transliterim ndërhyrje masive redaksionale përfiksimin dhe përmirësimin e llojit të theksave, çka do ta shpërfytyronte të gjithë tekstin original. Prashtu ecim të sigurt në atë hulli të hapur dhe përshkuar prej Papahagi-t (1909 116vv.) e të vijuar edhe prej Kristophson-it (1974 21v.), sa u përket premisave metodike në punën filologjike me tekstet shqipe me alfabet greqisht.

Në mbyllje vëmë në dukje edhe do probleme aspak të vogla, që shoqërojnë tekstin shqip, shkrimi e fjalëve e frazave të tëra bashkë ose me ndarje të paqëlluara të njësive grafike. Lexuesi do të përditësohet lehtë me këtë rrethanë, në rast se shfleton edhe faksimilet e botimit original me faqet përkatëse¹. Vështirësinë e ndarjes së fjalëve në fjalë e konkuron shpesh mungesa e fiksimit me pikë të fjalive të tëra brenda një rubrike, por edhe ajo e germave majuskula, të cilat na shfaqen shpesh si raritetë në dorëshkrim. Pre e kësaj praktike ortografike kanë rënë shpesh edhe emrat e përveçëm sikurse nocionet themelore të besimit dhe të teologjisë kristiane-ortodokse (*nomina sacra*), të cilat i ngjerojmë në shumësinë e tyre me minuskula. Gjithsesi, vështirësitë e kësaj natyre janë të tillë që nuk i lënë patjetër dorë të lirë vullnetit të studiuesit me ndërhyrë arbitrarisht e në varësi me shkallën e njohjes dhe të ndërgjegjes gjuhësore.

¹ Sh. shën. 5.

4.2 “Ndikime” gjatë hedhjes në letër të fjalësit shqip

Një temë e veçantë studimi, së cilës në fakt i kemi anashkaluar në punimin tonë, por që shpresojmë ta rimarrim në një tjetër shkrim të radhës janë “ndikimet” e mundshme të natyrës grafike ortografike në hedhjen në letër të gjuhës shqipe me alfabet greqisht prej autorëve të ndryshëm arumunë si Terpo (1731), Kavalioti (1770), Dhanili (1802) etj. Po mjaftohemi të citojmë me këtë rast Lloshin (së fundi 2008 303v.), sipas të cilit: “Përfundimi më i rëndësishëm nga shqyrtimi i alfabetit te Dhanili është se ai gjithashtu ka ndërtuar një alfabet të përshtatur prej greqishtes pér të shkruar arumanishten dhe pastaj këtë alfabet e ka përdorur edhe pér bullgarishten, edhe pér shqipen. Një e vërtetë kaq e qartë dhe e vetëkuptueshme është shpërfillur në studimet tona pér një periudhë të gjatë vetëm e vetëm, sepse i është bërë bisht një të vërtete tjetër po aq të qartë e të vetëkuptueshme: këta kanë qenë arumunë shqiptarë. Dëshiroj të përsëris fjalët e Eqrem Çabejt. “Me Teodor Kavaliotin fillon periudha e shkurtër e kulturës arumune në Shqipëri.”

Asgjëmangut kemi të bëjmë me një temë të patrajtuar deri sot sa e si duhet në studimet tona filologjike e në të cilën edhe Lloshi vetë kufizohet vetëm në konstatime të rastit. Prashtu është ndoshta më frutdhënëse pér momentin, të analizojmë tekstin e Mjeshtër Dhanilit thjesht si tekst të mëvetësishëm, duke krijuar mundësinë e përqasjeve ballore në kulturën e shkrimit shqip me alfabet greqisht në studime të ardhshme.

Po ashtu mbetet pér t'u hulumtuar edhe shqipja si e tillë në ndërgjegjen gjuhësore të autorit, çka lidhet qoftë me recepcionin ashtu edhe me nyjëtimin të fjalëve shqip prej autorit duke përsiatur sipas rastit mundësinë e ndikimit të rregullave fonotaktike të arumanishtes në përdorimin e shqipes si të tillë.

Këtë çështje që e kemi cekur kalimthi më lart në paraqitjen grafike të zanores qendrore [ə] (sh. tabelën §4 dhe §4.1) do ta rimarrim rast pas rasti në rubrikën “Shënime” që pason tabelën e riprodhimit diplomatik si edhe transliterimin e tekstit shqip me kodin e sotëm alfabetik të shqipes (§5.3)

5. Çështje të botimit kritik të tekstit shqip

Ndërmarrja jonë pér botimin kritik të materialit shqip në fjalorin e Mjeshtër Dhanilit, e parashikuar të shohë dritën e botimit në një të

ardhme të afërt, përshkon tri fazë pune që ndjekin dhe plotësojnë njëra-tjetrën:

1. Riprodhimi diplomatik i teksteve paralele greqisht, arumanisht dhe shqip me alfabet greqisht, duke mbajtur gjithherë parasysh facsimilet e botimit të vitit 1802 (§5.2: kolona I, II, III).

2. Kjo rrethanë e lehtëson punën në fazën e dytë për tejshkrimin e zgjeruar të tekstit shqip me kodin e sotëm alfabetik të shqipes (§5.2: kolona IV) e që përbën në vetvete hapin ndërmjetës për të ndërmarrë me sukses

3. botimin e tyre të përkujdesur filologjik si tekst i normalizuar dhe i përshtatur për një lexim të rrjedhshëm në një rrëth shumë më të gjërë lexuesish të interesuar (§6).

Ndërsa për rëndësinë e zbardhjes së tekstit greqisht (kol. I) në studimin tonë si tekst burimor nuk jemi të detyruar t'i përcjellim lexuesit argumente të rastit, për ngérthimin e tekstit arumanisht (kol. II) në studim duhet të bëjmë sqarime të tilla, në kuptimin që ai është më se i domosdoshëm në përqasje ndër më të ndryshmet që kanë të bëjnë me punën filologjike me tekstin shqip, bash ashtu siç vërehet edhe në shumë e shumë shënime (§5.3) që shoqërojnë riprodhimin diplomatik dhe transkriptimin e zgjeruar të tekstit shqip. Nuk kemi mbajtur parasysh në punimin tonë pjesën maqedonisht-bullgarisht të fjalorit për një arsyё të thjeshtë, thuajse triviale e që njihet prej kohësh: kjo pjesë nuk ka për autor Mjeshtër Dhanilin.¹

5.1 Riprodhimi diplomatik i tekstit shqip

Riprodhimi diplomatik si fazë e parë e ndërmarrjes tenton drejt një riprodhimi sa më të përpiktë të tekstit burimor në të tria gjuhët, pra nuk kemi ndërhyrë për përmirësimë të rastit që mbështeten në normat e sotme ortografike, si p.sh.: segmentimi përkatësisht shkrimi bashkë apo ndaras i fjalëve, i pjesëzave dhe i shenjuesve gramatikorë. Rrallë edhe në anotim (me kllapa rrumbullake) janë bërë për arsyë vendi zhvendosje të pjesshme të rreshtit duke vendosur një pjesë së strukturës grafike të një fjale nistore ase fundore një rresht më lart apo më poshtë. Është përdorur gjithashtu edhe nënvizimi, sidomos për pjesën greqisht (kol. I) dhe atë shqip (kol. III), kur kemi të bëjmë me

¹ Sh. së fundi Lloshin 2006 88v.

shmangie dhe lexime të ndryshme prej varianteve të botuara ndërkokë prej Papahagi-t (1909) dhe Kristophson-it (1974).

5.2 Tejshkrimi i zgjeruar i pjesës shqip

Faza e dytë e punës sonë filologjike me tekstin original rrudhet në tejshkrimin e zgjeruar të pjesës shqip (kol. IV), parë ky si botim e përkujdesur kritik me kodin e sotëm alfabetik të shqipes. Sa i përket procesit të zëvendësimit të kodit alfabetik në tekstin original me atë të shqipes së sotme letrare, realizimin e tij e mundësoi puna paraprake për zberthimin e këtij kodit në tekstin original, përkatësisht njohja dhe saktësimi i vlerave fonetike funksionale të tingujve që përcjell ky kod. (sh. tabelën §4) Siç është vënë në dukje edhe në vëzhgimet redaksionale hyrëse që i bashkohen kësaj pjese (§§ 4.1-4.2), synimi ynë kryesor në këtë fazë pune ishte riprodhimi sa më i saktë i vetë tekstit original me kodin alfabetik të shqipes së shkruar, pra me një sistem tjetër (orto)grafik, i cili mundëson leximin e tij të rrjedhshëm prej lexuesit të sotëm, por që në të njëjtën kohë e ruan koloritin gjuhësor e stilistik të autorit.

Për t'i mundësuar lexuesit, qoftë ky edhe filolog specialist, përditësimin me tekstin original dhe leximin e tij të rrjedhshëm, janë ndërmarrë në tejshkrim do ndërhyrje që mbështeten në normën e sotme ortografike, gjithsesi duke u kufizuar këtu:

- a) në segmentimin e fjalëve, nyjave ose pjesëzave gramatikore të shkruara bashkë,
- b) në pikësimin e fjalisë dhe të periudhës, sipas normës së sotme ortografike,
- c) në zbatimin pak a shumë të po kësaj norme lidhur me shkrimin e fjalëve me shkronjë të madhe.
- d) në markimin me nënvizim të variacionit grafik, që vështirëson leximin ose shkakton kolision mes njësish të ndryshme leksiko-gramatikore, të cilat sqarohen me shpjegimet përkatëse në aparatin filologjik (§5.3)

Ndonjë ndërhyrje tjetër e natyrës redaksionale dhe çështje gjithfarësh që lidhen me shqyrtimin dhe interpretimin e tekstit për nga perspektiva gjuhësore-filologjike janë rrokur po ashtu në rubrikën e zgjeruar “Shëname” (§5.2) që përmbyll dy fazat e para të punës me tekstin e me synimin largvajtës për të informuar lexuesin me detaje

shtesë, duke rrokur këtu sipas rastit edhe të dhëna statistikore që tumirin njërën apo tjetrën ndërhyrje redaksionale në tekst.

Si shembëllzim i punës filologjike me tekstin po i përcjellim lexuesit në vazhdim faqen e parë të riprodhimit diplomatik të teksteve greqisht, arumanisht, shqip së bashku me kolonën e katërt të transkriptimit të tekstit shqip:

f.	I = a	II = d	III = b	IV = c	
	‘Ρωμαϊκα	Βλάχικα	Άλβανίτικα	Shqip	rr.
1	‘Ο Θεὸς έκαμε τὸν οὐρανὸν , τὴν γῆν τὸν ἥλιον τὸ φεγγάρι τὰ ἄστρα . Καὶ ὑστερα ἐπρόσταξε τὴν θάλασσαν ταῖς λίμναις τὰ ποτάμια καὶ εὐγαλαν τὰ ὄφαρια τὰ χέλια . Πάλιν εἶπε καὶ εὐγήκαν ἀπάνω εἰς τὴν γῆν ὅλα τὰ δένδρα . Καὶ εἶναι ἡ γῆ γεμάτη ἀπὸ ξύλα δρύϊνα . ἀπὸ ὀξειάν ἀπὸ ἵτεαν ἀπὸ λεῦκον	Τουμνιτζάου φέτζε τζερόου λόκλου σοάρλε λοῦννα στιάλλε. Σσήταπόϊα ούρσῃ άμάρια πάλτζηλε ράουρρε σσήσκοάσιρα πέσκηλι ούχέλληλε. Ναπόητζῆσε σσήσσηρε πεσούπραπρέ λόκου τούτζηάρπου ρλλι. Σσήέσταλόκλ ου μπλήνου τέλιάμνε τέκουπάτζου . Τέφάκου τέσάλτζε τέπλούπου	Περαντία μπάρη κίελτ δέννα τίελλνα χάννζεα ιούγιετ . Έδε παστάη ούρδαρόη τέτνα γκιόληρατ λιούμφαρατ έδε ντζούαρα πέσκιτ γκιάλλιατα . Παρσαρῇ θᾶ έδε τούαλλα σήπαρ μπή δέτ γκιθά τρούρατ . έδε ἔστα δέου πλιότ πὲ τροῦ πὲ τούσκου . Πὲ χάου πὲ σσέλκου πὴ πλέπη	Perëndia bëri qiellt, dhenë, diellnë, hënzenë, yjet. Edhe pastaj urdhëroi detnë, gjolirat, lumërat edhe nxuarë peshqit, ngjalatë. Përsëri tha edhe duallë sipër mbi dhet gjithë drurët. Edhe eshtë dheu plot pe dru pe dushku, pe hau, pe shelku, pi plepi,	0001 0005 0010 0015 0020 0025

5.3 Shënime

- 6b <χάννζεα> = c *hënzenë*: JK 14, shën. 7: <χάνζενα>.
- 11b <γκιόληρατ> = c *gjolirat*. Në tekst shfaqet shpesh zanorja e patheksuar -i- në vend të *-ë- në trup të fjalës dhe duhet të jetë pas gjithë gjasash karakteristikë e së folmes native të autorit, në të cilën vërehet shpesh ndërndërrimi i zanoreve të patheksuara ë ~ e ~ i. (Capidan 1929-1930 171, 178, 183v.)
- 13b <ντζούαρα> = c *nxuarë*. Në tekst nuk ka shpërndarje të rregullt grafike për bashkëtingëlloret vibrante *r* ~ *rr*. (§4: tabela e kodit alfabetik)
- 20b <ξτα> = c *eshtë*. Fjalëformë që përkon plotësisht gjegjësen e saj në arumanisht: 20d <ξτα>.
- 22b <πὲ τροῦ> = c (*plot*) *pe dru*: Parafjala pebart në tekst shpesh edhe funksionet e parafjalës *me*, khs. 256...257c (βρέστα ... πλιότ) πὲ ρούσσ = c *vreshtë plot pe rrush*; 281b <πέ ννιέρεζ> = c *pe njérëz* (= *me njérëz*) etj.
- 24b <χάου> = c *hau*: Variant dialektor i (*pe*) *ahu rrj.nj.pashq*. “(aus) Buche”. Ndryshe JK 14, shën. 8: corr. për *<άχου>.
- 26b <πὴ πλέπη> = c *pe plepi* (corr. J.K.: shën 6.)

6. Teksti i normalizuar shqip

Teksti i normalizuar, d.m.th. i përkujdesur i pjesës shqip në fjalor përmbyll fazën e tretë dhe të fundit të punës sonë filologjike me tekstin burimor.(§6) Asgjëmangut éshtë e tepërt të insistojmë për të bindur më shumë lexuesin se edhe në këtë fazë pune filologjike me tekstin nuk kemi pasur aspak qëllim në vetvete me (ri)ndërtuar një tekst gjuhësor-normativ, gjë që për nga perspektiva filologjike do të ishte në mos i pamundur, të paktën një shfytyrim i plotë i tekstit burimor. Me normalizim të tekstit kuptojmë thjesht dhe vetëm sistematizimin, përkatësisht thjeshtimin e variacionit grafik në botimin e viti 1802, të cilin e kemi fiksuar me akribinë e nevojshme dhe interpretuar në detaj në rubrikat plotësuese të shënimeve gjithfarësh në dy fazat e mëparshme të punës që janë riprodhimi diplomatik dhe tejshkrimi i zgjeruar. (§5.2) Përkundrazi nuk éshtë “vënë dorë” assesi në variacionin individual dhe dialektor në ndërgjegjen gjuhësore të autorit, përpos rasteve të rralla të shkrimit të ë-së kur konteksti gjuhësor kërkon lexim të rrjedhshëm. Përfundime të kënaqshme mundën të arriheshin në këtë rast në sajë të krehjes statistikore dhe drejtbeschimit të dhënavë që paraqesin: a) gjendja e përgjithshme e sistemit gjuhësor të shqipes në periudhën

kur u shkrua teksti; b) gjeografia gjuhësore e tekstit shqip, shi përkatësia dialektore e trevave përreth Voskopojës; c) veçoritë dhe trashëgimia e lëvrimit të shkrimit shqip në Arealin Kulturor ortodoks në hapësirën kompakte shqipfolëse gjatë dhe para kësaj periudhe; e bashkë me të edhe d) tradita e botimit filologjik të teksteve të vjetra shqipe që i takojnë këtij areali (Papahagi 1909; Jochalas 1985; Hetzer 1981a/b; Kristophson 1974; Qafëzezi [†]2019,[†]2020 etj.) e sigurisht e) përqasjet fatlume me tekstin paralel arumanisht dhe situatën gjuhësore të arumanishtes në hapësirën shqipfolëse, sidomos në trevat e epërme të Areilit të Jugut ortodoks shqiptar (Capidan, Th. 1928-9; 1932; Capidan, T. 1963).

Të gjitha këto vërejtje e shënimë që përmblodhëm në këtë krye, së bashku me riprodhimet e tekstit dhe botimin e tij kritik, kanë thjesht për qëllim të lehtësojnë leximin, në mënyrë që lexuesi të përcjellë vetë rëndësinë historike gjuhësore dhe letrare të këtij thesari të çmueshëm në kulturën e shkrimit shqip, ashtu siç e njëron më poshtë në dy faqet e para, që po ia përcjellim si shembëllzim, si vijon:

Tentativë e tekstit të normalizuar

[f.1]

Perëndia bëri qiellt dhenë diellnë hënëzënë yjet. Edhe pastaj urdhëroi detnë, gjolirat, lumërat edhe nxuarë peshqit, ngjalatë. Përsëri tha edhe duallë sipër mbi dhet gjithë drurët. Edhe eshtë dheu plot pe dru pe dushku, pe hau, pe shelku, pe plepi, [f. 2] pe selvie, pe borigë. Edhe të tjera gjendenë ndë pyll. Të tjerë janë ndë malet ndë fushë edhe ndë të tjerë vise.

Përprapa mbinë luletë, barirat, lakrat, hitrat. Edhe gjithë u bënë prë njeriut. Pas këto u bënë bagëtitë, egrëtirat. Edhe nga këto ca haenë edhe ca punojnë prë ihtiza tenë.

Asllani, ujku, ariu, spriha, dhelpëra, [...]

7. Përfundim

Shpresojmë të kemi realizuar në këtë studim, së paku atë qëllim modest që sinjalizuam në hyrje të tij lidhur me rishqyrtimin filologjik-gjuhësor të materialit shqip në Λεξικόν τετράγλωσσον (= shq. *Fjalor katërgjuhësh*) si pjesë e parë (f. 1-36) e librit mësimor Eisagwagikή Διδασκαλία (= shq. *Mësim hyrës* – 1802) me autor Mjeshtër Dhanilin.

Përditësimi i lexuesit me atë qerthull problematik që rrok veprën dhe personalitetin e autorit të saj u trajtua prej shkruesit të këtyre radhëve më fort si një farë detyrimi profesional ndaj lexuesit sqimatar, çka shpresojmë të mos ketë hijezuar aspak qëllimin kryesor të studimit që është botimi kritik i tekstit shqip në atë fjalor, i cili nuk është bërë ende si i tillë – më saktë në plotësinë e vet! – pronë e rretheve shkencore-intelektuale në hapësirën kulturore shqipfolëse.

Në paraqitjen e kornizës para- dhe peritekstuale të veprës (§§1-3) iu përcoll lexuesit pjesa hyrëse e panumëruar e librit (f. I-VI) si tekst origjinal greqisht me përkthimin përkatës shqip, në mënyrë që edhe ai të krijojë një ide më të qartë, duke pjesëmarrë vetë në diskurs lidhur me atë qerthull problematik që bartin synimet largvajtëse, që supozohet të ketë pasur autorit i saj brenda konceptimit dhe realizimit të librit mësimor e që duket të ketë të bëjë me helenizimin gjuhësorkulturor të bashkësive etnike jogreke që ndanin së bashku besimin e krishterë ortodoks në Arealin Kulturor të Jugut shqiptar. Duke relativizuar autorësinë e (vetëm) njërit paratekst që senderton hapur këtë tendencë ideologjike-fetare të asimilimit kulturor-gjuhësor jemi rrekur njëherësh të qetësojmë shpirrat e rretheve intelektuale-shkencore shqiptare që e kanë degdisur në *index-in* e literaturës së ndaluar tekstin mësimor si të tillë e bashkë me të edhe materialin shqip të rrokur në të e që padyshim i takon trashëgimisë së vyer të kulturës së shkrimit shqip me alfabet greqisht në fund të shek. XVIII.

Puna për riprodhimin diplomatik dhe transkriptimin e zgjeruar të materialit gjuhësor (§§5-5.3) u shoqërua në çdo hap me analizën grafematike-filologjike dhe atë gjuhësore të tekstit (§§ 4-4.2). Asgjëmangut, në këtë fazë pune tejet të vështirë ndihmuani gjithashtu si përqasjet në vijimësi me tekstin burimor greqisht ashtu edhe, madje sidomos, sosh me tekstin gjegjës arumanisht, që përcjell në letër karakteristikat e së folmes native të autorit dora vetë, përkatësisht mënyra e perceptimit të shqipes dialektore në ndërgjegjen e tij gjuhësore. Mbajtja parasysh e këtyre rrethanave i dha dorë dhe siguri fazës së fundit të punës sonë filologjike me tekstin, që është pikërisht realizimi i një teksti të normalizuar (§6) që mundëson leximin e rrjedhshëm për lexuesin e interesuar, pa qenë patjetër filolog.

Parë nga të gjitha këto perspektiva shpresojmë që teksti dhe autorit i saj të bëhen dikur pronë e studimeve shqiptare, duke i dhënë vendin dhe rolin e padiskutueshëm si dëshmitar okular i atij mozaiku

gjuhësor-kulturor në një zonë historikisht të njojur për bashkëjetesën ndëretnike e ndërkonfesionale: “Është kjo një zonë që sendërtón Nyjën e Gordonit në historinë e kulturës së shkrimit shqip, e cila mund të zgjidhet dhe do zgjidhur në bashkëvajtje me njojen dhe studimin e këtij komponenti sa të ri aq edhe të hershëm të saj: shi të kulturës së shkrimit arumanisht në Arealin Kulturor Ortodoks brenda hapësirës shqipfolëse.” (Demiraj 2019c 127) E kjo nyjë sigurisht nuk mund të zgjidhet asesi pa pasur në tavolinën tonë punës njëren ndër veprat madhore të Jubilarit tonë, bash botimin kritik të fjalorit greqisht-shqip të Marko Boçarit (1980), që hapi një hulli të re në botimet kritike të trashëgimisë së kulturës së shkrimit shqip me alfabet greqisht në historinë e filologjisë shqiptare.

Bibliografi

Capidan, Theodor

1929-30 Fărşeroṭii. Studiul lingvistic asupra românilor din Albania, në: Dacoromania. Buletinul “Muzeului limbei române” Anul VI 1929-1930. Bucuresti 1-210

1932 Aromâni. Dialectul aromân. Studiu lingvistic, në radhojën “Studii și cercetări”, bl. XX. Academia Română. București.

Daniil Moschopolitis [= Δανιήλ Μοσχοπολίτης]

1802 ΕΙΣΑΓΩΓΙΚΗ ΔΙΔΑΣΚΑΛΙΑ Περιέχουσα Λεξικόν Τετράγλωσσον τῶν τεσσάρων κοινῶν Διαλέκτων ἦτοι τῆς ἀπλῆς Ρωμαϊκῆς, τῆς ἐν Μοισίᾳ Βλαχικῆς, τῆς Βουλγαρικῆς, καὶ τῆς Ἀλβανιτικῆς

Demiraj, Bardhyll

2018 Arumanisht në Kodikun e Kostë Cepi-Vithkuqarit – Homazh Ilo Mitkë Qafëzezit, në: “Studime filologjike” 3-4, f. 105-112. Tiranë.

2019a Kodiku Beratas – O Μπερατινός κώδικας (me një botim kritik të pjesës shqip të përgatitur nga Bardhyll Demiraj), ASHSH Tirane.

2019b Dorëshkrimi shqip në Veneranda Biblioteca Ambrosiana të Milans (B 112, sup; fol 63^{r/v}), in: “Studime” 26 [2019] 43-103. Prishtinë 2020.

2019c Enigma e Gravurës së Ardenicës, in: “Shêjzat – Le Pleiadi” 1-2 [2019] 101-129

2020a (& Sokol Çunga) Ein albanisches Manuscript im Handschriftenbestand der Klosterbibliothek der Heiligen Trinität auf der Insel Chalki, in: “Altalbanische Schriftkultur – aus der Perspektive der historischen Lexikographie und der Philologie der Gegenwart. Akten der 6. Deutsch-Albanischen Kulturwissenschaftlichen Tagung (27. September 2019,

- Buçimas bei Pogradec, Albanien)“ (Herausgegeben von Bardhyl Demiraj), aus der Reihe: “Albanische Forschungen“ Bd. 44, Wiesbaden 2020, S. 239-268
- 2020b Kodiku i Kostë Cepit – Vithkuqarit (1822-1823) III. Vendì i tij në trashëgiminë e kulturës së shkrimit shqip me alfabet grek
- Hetzer, Armin
- 1981a Das dreisprachige Wörterverzeichnis von Theodoros AnastasiuKavalliotis (Herausgegeben von Armin Hetzer). In: BA n.F. (Beiheft, Bd. 1) Hamburg 1981; Aktualisierte Neuausgabe. Hamburg.
- 1981b Der sog. Kodex von Berat, Teil I, në: “Balkan-Archiv“ N.F. 6, f. 125-197
- 1982 Der sog. Kodex von Berat, II, në: “Südost-Forschungen” 41, 132-179
- Jochalas, Titos
- 1980 /To helleno-albanikon leksikon toy Markoy Mpotsari/. Athinai Kavalioti, Thedhor [= Theodōros Anastasios Kaballiōtēs]
- 1770 /Prōtopeiria para tou sophologiōtatu/, Venedik 1770 (:παρά τοῦ σοφολογιωτάτου καὶ αἰδεσιμωτάτου Διδασκάλου Ἱεροκήρυκος, καὶ Πρωτοπαπᾶ Κυρίου ΘΕΟΔΩΡΟΥ ΑΝΑΣΤΑΣΙΟΥ ΚΑΒΑΛΛΙΩΤΟΥ ΤΟΥ ΜΟΣΧΟΠΟΛΙΤΟΥ ΕΥΝΤΕΘΕΙΣΑ. ΕΝΕΤΙΗΣΙΝ 1770)
- Kristophson, Jürgen
- 1974 Das Lexikon Tetraglossen des Daniil Moschopolitis. In: ZfB 10, f. 7-128.
- Kyriazis, Doris K.
- 2019 Greek-Albanian and Albanian-Greek lexicography in the 18th and 19th centuries. Në: “Studies in Greek Lexicography” (Edited by G. K. Giannakis, Chr. Charalambakis, Fr. Montanari and A. Rengakos) In honor of John N. Kazazis; in the series: “Trends in Classics – Supplementary Volumes”, bl. 72. De Gruyter. Berlin/Boston, pp. 41-56
- Leake, William Martin
- 1814¹ Researches in Greece. London 1814. (Sh. edhe poshtë Lloshi 2006)
- Lloshi, Xhevati
- 2006 (Pjesa hyrëse në:) William Martin-Leake: Kërkime për shqiptarët dhe për gjuhën shqipe në librin Researches in Greece. Londër, 1814. Përkthyer dhe paraqitur nga prof. dr. Xhevati Lloshi. Tiranë 2006.
- 2008 Rreth alfabetit të shqipes. Tiranë
- Miklosich, Franz
- 1882 Rumunische Untersuchungen I. Denkschriften der k.k. Akademie der Wissenschaften, phil. Hist. Cl. 32. BD.1882: 229-245). Wien.
- Papahagi, Pericle
- 1909 Scriitorii Aromâni în secolul al XVIII (Cavalioti, Ucuta, Daniil), Bucureşti.
- Papahagi, Tache

1963 Dictionarul dialektului aromân. Bucureşti.

Qafëzezi, Ilo Mitkë

2019[†] (Demiraj, B. – ed.) Ilo Mitkë Qafëzezi: Kodiku i Kostë Cepit – Vithkuqarit (1822/3) I. Veprimtari krijonjëse – AQSH: Fondi I.M.Q.; D. nr. 52, v. 1938 (përgatiti për botim Bardhyl Demiraj), në: “Studime Filologjike 1-2,225-268.

2020[†] (Demiraj, B. – ed.) Ilo Mitkë Qafëzezi: Kodiku i Kostë Cepit – Vithkuqarit (1822/3) I. Veprimtari krijonjëse – AQSH: Fondi I.M.Q.; D. nr. 18, v. 1938 (përgatiti për botim Bardhyl Demiraj), në: “Hylli i Dritës” 2, 100-130 Shuteriqi, Dhimitër

1976 Shkrimet shqipe në vitet 1332 – 1850. Tiranë.